



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale

**Analizë gjinore+ për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në
Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë 2016–2018**



Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale

**Analizë gjinore⁺ për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në
Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë 2016-2018**

Nga Donjeta Morina dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

Prishtinë, Kosovë
2015

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2015

Autorë: Donjeta Morina dhe Nicole Farnsworth

ISBN 978-9951-8852-9-4

Përkthyer nga: Mars A

Printuar nga Night Design në Prishtinë

www.womensnetwork.org

Përmbajtja

Mirënjohje.....	2
Akronimet.....	2
Përmbledhje ekzekutive	3
Gjetjet	3
Rekomandimet	5
Hyrje	8
Të dhënat kryesore demografike për të ofruar informata për analizën gjinore	9
Përgjegjësitë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.....	10
Divizioni për Burime Njerëzore	11
Sistemi Pensional në Kosovë.....	12
Pensioni bazë.....	12
Pensioni kontribut-pagues	14
Pensioni i aftësisë së kufizuar	16
Pensioni i parakohshëm për punëtorët e Trepçës	18
Divizioni për Çështje Trashëgimore të Trupave Mbrojtëse të Kosovës	18
Pensionet për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës	19
Pensioni për personat e verbër	20
Departamenti i Punës dhe Punësimit	21
Personat e regjistruar në Zyrat e Punësimit	21
Personat e punësuar përmes Zyrave të Punësimit.....	23
Përfutjesit e Programeve Aktive të Tregut të Punës	25
Divizioni për Aftësim Profesional	26
Pushimi i lehonisë	27
Papunësia dhe punët e kujdesit	27
Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes	28
Divizioni për Ndihma Sociale	28
Divizioni për Shërbime Sociale	33
Ndihma familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.....	34
Strehimi familjar për fëmijët e braktisur.....	35
Strehimoret për mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare.....	36
Divizioni për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe për Persona të Moshuar	38
Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës	40
Familjet e Dëshmorëve	41
Viktimat civile	42
Invalidët e UÇK-së	43
Invalidët civilë	43
Personat e zhdukur të UÇK-së.....	44
Personat e zhdukur civilë.....	45
Familjet e invalidëve të vdekur të luftës.....	46
Familjet e invalidëve të vdekur civilë	46
Kujdestarët e invalidëve civilë	47
Kujdestarët e Invalidëve të Luftës.....	47
Bibliografia.....	49

Mirënjohje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) falënderon Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z Arban Abrashi, i cili ofroi mbështetjen e tij të plotë gjatë procesit të realizimit të kësaj analize. Gjithashtu falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm, z. Izedin Bytyqi dhe z Nexhat Sylja, zyrtar i financave, për mbështetjen e tyre të madhe. Këshilltarët politikë të Ministrit, z Fatmir Haxholli dhe z. Alban Bokshi po ashtu e kanë ndihmuar procesin. Kjo analizë nuk do të kishte qenë e mundur pa kontributin e rëndësishëm të drejtorëve, zyrtarëve të financave dhe personelit për mbledhjen e të dhënave nga të gjitha departamentet dhe divizionet në kuadër të Ministrisë. Autorët gjithashtu falënderojnë Drejtoreshën Ekzekutive të RrGGK-së, zn. Igballë Rogova për inkurajimin dhe mbështetjen e saj gjatë gjithë procesit.

GIZ-i me mirësi ofroi mbështetje financiare për këtë analizë dhe për mbështetjen teknike të RrGGK-së në Ministri gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave.

RrGGK-ja gjithashtu dëshiron të falënderojë Iliriana Banjskën dhe Elizabeta Muratin, të cilat mbështetën mbledhjen dhe analizën e të dhënave, si dhe Ada Shimën për komentet dhe sugjerimet e saj të vlefshme për draftin e parë të raportit.

Akronimet

PATP	Programi Aktiv i Tregut të Punës
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve
QSGF	Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve
SIMP	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit
GIZ	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</i>
BPGj	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor
APK	Administrata Pensionale e Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
LGBT	Lezbike, Gei, Biseksualë, Transgjinnorë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizatë jo-Qeveritare
MVPT	Mbrojtja e Viktimave dhe Parandalimi i Trafikimit
RAE	Roma, Ashkali, dhe Egjiptianë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes
SAS	Skema e Asistencës Sociale të Kosovës
DSHS	Divizioni për Shërbime Sociale
QMS	Qendra për Mirëqenie Sociale
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
QMG	Qendra për Mirëqenien e Gruas

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport analizon përgjegjshmërinë gjinore të dy kategorive ekonomike në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS): pagat dhe mëditjet, si dhe subvencionet dhe transferet. Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) mundëson planifikim dhe ekzekutim të buxhetit në mënyrë më efektive, efikase, transparente dhe të barabartë. BPGj-ja përfshin integrimin e perspektivës gjinore në proceset dhe dokumentet buxhetore dhe kërkon një analizë të ndikimit potencialisht të ndryshëm që shpenzimet e planifikuara dhe burimet e alokuara kanë të burrat dhe gratë. Përtej dallimeve gjinore, buxhetet duhet të kujdesen për nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave të *ndryshëm*, të referuar në këtë raport si “Gjinia⁺”. Gratë dhe burrat e ndryshëm mund të kenë prioritete, interesa, dhe nevoja të ndryshme. Për shembull, banorët e fshatrave mund të kenë nevoja që ndryshojnë nga nevojat e personave që jetojnë në qytete; nevojat e grave të reja ndryshojnë nga ato të burrave më të vjetër; nevojat e personave të papunë ndryshojnë nga ato të personave të punësuar; personat e grupeve etnike të ndryshme mund të hasin në probleme të ndryshme. Pasi që qeveria është përgjegjëse për krijimin e politikave nga të cilat do të përfitojnë qytetarët e saj të ndryshëm, buxhetet qeveritare duhet të sigurojnë që nevojat e ndryshme të qytetarëve të ndryshëm të merren parasysh dhe të trajtohen gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

Gjetjet

Divizioni për Burime Njerëzore

- Pavarësisht përmirësimeve që nga viti 2014, gratë shqiptare mbeten të nën-përfaqësuar në MPMS, veçanërisht në nivelet e vendimmarrjes dhe për sa u takon shkallëve më të larta të pagës. Burrat janë fare pak të nën-përfaqësuar në nivelet e shkallëve të ulëta të pagave.

Sistemi Pensional në Kosovë

- Gratë vazhdimisht përfitojnë më pak nga pensionet kontribut-paguese sesa burrat, sepse ato kishin më pak mundësi të punësoheshin gjatë viteve të tyre të moshës së punës.
- Më shumë gra se burra marrin pensione bazë.
- MPMS-ja aktualisht nuk mban të dhëna të ndara sipas të gjitha përkatësive etnike dhe vendndodhjes gjeografike.
- Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se jo të gjithë personat me aftësi “të konsiderueshme” të kufizuar marrin këtë pension.
- Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë edhe se më shumë gra sesa burra kanë aftësi të kufizuara. Gratë mund të mos kenë informata në lidhje me këto përfitime.
- Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se jo të gjithë personat me aftësi “të konsiderueshme” të kufizuar marrin këtë pension.
- Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë edhe se më shumë gra sesa burra kanë aftësi të kufizuara. Gratë mund të mos kenë informata në lidhje me këto përfitime.
- Numri dhe përqindja e grave shqiptare dhe jo-shqiptare përfituese të këtij pension ka rënë në mënyrë të konsiderueshme nga viti 2014 në vitin 2015 për shkak se kanë filluar që në vend të tij të marrin pensionet kontribut-dhënëse.
- Edhe pse të dhënat e regjistrimit sugjerojnë se ka më shumë gra të verbra sesa burra, më shumë burra e kanë marrë këtë pension. Gratë e verbra shqiptare në veçanti mund të mos jenë në dijeni për të drejtën e tyre për këtë pension. Burrat e verbër shqiptarë gjithashtu marrin më shumë fonde të pensioneve se sa gratë e verbra shqiptare, edhe pse arsyet janë të paqarta.

Departamenti i Punës dhe Punësimit

- Burrat shqiptarë kanë tendencë të përfitojnë më shumë nga shërbimet e punësimit se sa gratë shqiptare, edhe pse gratë shqiptare kanë tendencë të jenë të papuna në shkallë të lartë, veçanërisht gratë e reja.

- Në mesin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, burrat gjithashtu priren të jenë të regjistruar në shërbimet e punësimit më shumë se gratë e të njëjtit grup etnik.
- Anketa e Fuqisë Punëtore për vitin 2014 nuk përfshinte të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.
- Zyrat e punës kanë punësuar vazhdimisht pothuaj tri herë më shumë burra sesa gra. Burrat shqiptarë punësohen me shkallë më të lartë sesa gratë shqiptare në krahasim me popullatën e personave të papunë në Kosovë. Gratë nga të gjitha grupmoshat kanë më pak gjasa të regjistrohen në Zyrat e Punësimit, edhe pse ato kanë shkallë më të lartë të papunësisë sesa burrat.
- Në vitin 2014, vetëm 6% e personave të punësuar me ndihmën e zyrave të punësimit ishin gra të reja të moshës 15-24 dhe vetëm 3% ishin gra të moshave 40-54. Burrat e rinj të moshës 15-24 përbënin 23% të personave të punësuar. Burrat e moshës 25-39 ishin në mënyrë të konsiderueshme të mbi-përfaqësuar në mesin e personave të punësuar.
- Nuk janë mbledhur të dhëna në lidhje me numrin dhe përqindjen e grave dhe burrave ruralë dhe urbanë të regjistruar dhe të punësuar nga zyrat e punësimit.
- Ndonëse gratë dhe burrat kanë përfituar pothuajse në mënyrë të barabartë nga PATP-ja në vitin 2015, burrat kanë marrë një përqindje pak më të lartë të fondeve të shpërndara. Burrat gjithashtu kanë përfituar pak më shumë nga subvencionimi i pagave dhe programet e vetë-punësimit sesa gratë.
- Më shumë burra sesa gra kanë përfituar nga Qendrat për Trajnim Profesional, edhe pse është bërë progres në drejtim të rritjes së përqindjes së përfituesve gra në vitin 2015.
- Adresimi i shkallës së lartë të papunësisë të grave dhe pjesëmarrjes së ulët të tyre në fuqinë punëtore në tregun e punës kërkon vëmendje ndaj aktiviteteve të përkujdesjes dhe identifikim të mundësive alternative të kujdesit.

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes

- Për të dyja kategoritë mund të vërehet se ndërsa burrat kanë më shumë gjasa për të tërhequr ndihmën sociale për familjet e tyre, gratë kanë më shumë gjasa të jenë në mesin e anëtarëve të familjes që janë të varur prej saj.
- Totali i përfituesve sipas Kategorisë I të SNS-së është rritur prej vitit 2013 deri në vitin 2014, por pjesa e burrave dhe grave që përfitojnë sipas Kategorisë I të SNS-së ka mbetur e ngjashme. Ashtu si në vitet e mëparshme, shumica e anëtarëve të familjes në familje që përfitojnë nga Kategoria I e SNS-së janë gra (56% në 2014).
- Ndërsa burrat ende përfitojnë shumicën e buxhetit për SNS I (55% në vitin 2014), përqindja e grave që përfitojnë prej tij është rritur me dy për qind nga viti 2013 (nga 43% në 45%).
- Burrat kanë përbërë vazhdimisht shumicën e përfituesve të drejtpërdrejtë të Kategorisë 2 të SNS-së (91% në vitin 2012 dhe 2013 dhe 85% në vitin 2014). Megjithatë, përqindja e grave që janë përfituese të drejtpërdrejta është rritur për 7% nga 2013 në 2014 (nga 8% në 15%).
- Më shumë marrin mbështetje mujore familjet me djem me aftësi të kufizuara sesa familjet me vajza me aftësi të kufizuara. Kështu, më shumë buxhet shkon për familje të djemve (58%) sesa për familje të vajzave (42%).
- Nga viti 2011 deri në vitin 2015 të gjitha strehimoret, përpos njërës, kanë marrë një shumë të barabartë të fondeve vjetore nga MPMS-ja, pavarësisht nga numri i personave të strehuar. Duke filluar nga viti 2015, MPMS-ja u paguan strehimoret 208,33 € në muaj për një person të strehuar. Strehimoret kanë pasur përfitues vetëm gra dhe fëmijë. Aktualisht, nuk ka strehimore për burra dhe djem mbi moshën 12 vjeçare. Gjithashtu, nuk ka asnjë strehimore që i plotëson nevojat specifike të personave LGBT. Në aspektin e mbulimit gjeografik, nuk ka strehimore në veri të Kosovës, gjë që i kontribuon mungesës së qasjes në strehim në veçanti për personat serbë që përjetojnë dhunë
- Ekzistojnë shumë pak shtëpi për persona të moshuar dhe me aftësi të kufizuara në krahasim me madhësinë e mundshme të grupit të synuar. Kriteret për shfrytëzimin e shtëpive të tilla janë të rrepta dhe si të tilla ato mund t'i ekspozojnë personat e moshuar ndaj rrezikut që të qëndrojnë në situata të vështira në shtëpi.

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës

- Shumica e përfitimeve nga ky departament shkojnë teg gratë shqipëtare rurale, edhe pse edhe të tjerët i gëzojnë këto përfitime.
- Gratë shqiptare, kryesisht nga zonat rurale, përbëjnë shumicën e kujdestareve të personave me aftësi të kufizuara që rrjedhin nga lufta. Pensioni për kujdestarët e invalidëve të luftës është 4.5 herë më i lartë se pensioni për kujdestarët e invalidëve civilë. Megjithatë, përgjegjësitë dhe puna e kryer nga kujdestari janë të ngjashme. Duke pasur parasysh parimin "pagë e barabartë për punë të barabartë", kjo duket diskriminuese ndaj kujdestarëve të civilëve, të cilat kryesisht janë gra.

Rekomandimet

Divizioni për Burime Njerëzore

- Të vazhdohet rritja e përqindjes së grave të punësuar në nivele më të larta në shkallëve të pagës çdo vit derisa të arrihet kërkesa ligjore e punësimit të grave prej 50% në të gjitha nivelet e pagës. Kjo mund të arrihet kur vendet e punës hapen përmes veprimeve afirmative në procedurat e punësimit, siç është paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore.
- Të analizohen të dhënat gjinore të të punësuarve të MPMS-së, të ndara sipas gradës dhe nivelit të pagës për çdo vit

Sistemi Pensional në Kosovë

- Të mbahen të dhëna të ndara sipas gjinive dhe të gjitha përkatësive etnike.
- Verifikimi i numrit dhe përqindjes së përfituesve sipas përkatësisë etnike me anë të regjistrimit dhe të dhënave demografike mund ta lehtësojë "pastrimin" e listave të pensioneve. Kjo mund të sigurojë fonde të mjaftueshme për rritje të pensioneve bazë, pa pasur nevojë për ndonjë rritje të shpenzimeve, nëpërmjet shpenzimit më efikas.
- Të shqyrtohet rritja e pensioneve bazë dhe jo vetëm e pensioneve kontribut-paguese, në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës së personave të moshuar të cilët varen nga ky pension, veçanërisht grave.
- Të ruhen të dhëna të ndara sipas gjinisë për të gjitha grupet etnike.
- Të punohet me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara dhe me mediet për të siguruar që të gjithë të sensibilizohen për të drejtën e tyre për këtë pension, duke iu drejtuar me informata në veçanti grave.
- Të shqyrtohet prezantimi i një politike për shqyrtim parlamentar, e cila do t'u mundësonte personave me aftësi të kufizuar që të vazhdojnë të marrin të njëjtin pension kur arrijnë moshën mbi 65 vjeçare.

Departamenti i Punës dhe Punësimit

- Ndërmarrja e përpjekjeve aktive në terren në bashkëpunim me organizatat e grave dhe me medie që kërkojnë për të rritur numrin e grave shqiptare, rome, ashkali, dhe egjiptiane të regjistruara në zyrat e punësimit, duke rritur përqindjen e përfituesve që janë gra.
- Adresimi i normave të larta të papunësisë të grave në Kosovë, si prioritet i qeverisë, kërkon veprime afirmative nga Departamenti dhe zyrat e punësimit për të inkurajuar më shumë gra që të regjistrohen për ndihmë, veçanërisht gratë shqiptare dhe ato rome, ashkali dhe egjiptiane. Veprimet e tilla afirmative ndaj përmirësimit të barazisë gjinore në Kosovë janë të parapara me Ligjin për Barazi Gjinore.
- Kërkimi i të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, në mënyrë që ky informacion të mund të përdoret për analizë gjinore.
- Personeli i zyrës së punësimit duhet të trajnohet dhe pastaj të inkurajohet të përdorë veprime afirmative për të rritur përqindjen e grave, veçanërisht grave të reja, të cilave u sigurojnë punësim, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Kjo mund të arrihet duke vendosur një kuotë të përqindjes së vendeve të punës që zyrtarët duhet të gjejnë për gratë dhe burrat e moshave të ndryshme. Raporti gjinor që synohet për personat e punësuar në çdo grupmoshë mund të përmirësohet hap pas hapi çdo vit derisa të arrihet barazia.

- Duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë në mesin e grave të reja (71.7%) dhe të burrave të rinj (56.2%), zyrat e punësimit duhet të instalojnë veprime afirmative që do të inkurajojnë më shumë të rinj që të regjistroheni me zyrat e papunësisë, si dhe të caktojnë prioritet identifikimin e mundësive të punësimit për personat e këtyre grupmoshave.
- Të bashkëpunohet me OShC-të, veçanërisht OShC-të e udhëhequra nga gratë, për të inkurajuar më shumë gra që të regjistrohen në zyrat e punësimit. Përpjekjet për regjistrim duhet të synojnë në veçanti gratë e reja (15-24).
- Të fillojnë me mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin dhe përqindjen e grave dhe burrave që janë banorë të zonave rurale dhe urbane, të regjistruar(a) dhe të punësuar(a) nga zyrat e punësimit.
- Me qëllim zbutjen e papunësisë në Kosovë, si prioritet i qeverisë, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e pabarabartë të grave në tregun e punës dhe nevojën më të madhe të grave si një grup të synuar, mbështetësit e PATP-së dhe zbatuesit mund të bëjnë veprime shtesë afirmative që të sigurojnë që më shumë gra se sa burra të përfitojnë nga këto programe. Veprime të tilla afirmative duhet të zbatohen deri sa pjesëmarrja e grave dhe burrave në tregun e punës të arrijë një nivel të barabartë, siç parashihet me Ligjin për Barazi Gjinore.
- Të vazhdohet me zbatimin e veprimeve afirmative për të siguruar që gratë të regjistrohen dhe të përfundojnë aftësimin profesional së paku në përqindje të njëjtë me burra.
- Të investohet në objektet e përballueshme të kujdesit (private, publike, apo partneritetet publiko-private) si veprim afirmativ i paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore, që do të krijojë vende pune për gra dhe burra, si dhe do t'u mundësojë më shumë grave të punojnë duke ofruar shërbime të kujdesit.

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes

- Të kryhet një studim mbi arsyen pse më shumë burra përfitojnë SNS-së sesa gratë, si dhe mbi mënyrën se si shpërndahet ndihma sociale brenda familjes për të siguruar që anëtarët e familjes që nuk marrin ndihmë sociale të përfitojnë në mënyrë të barabartë. Nëse konstatohet se ekziston diskriminimin në praktikën e shpërndarjes, të identifikohen mënyrat për të siguruar që ndihma sociale të arrijë te të gjithë anëtarët e familjes.
- Të sigurohet që të gjithë personat që marrin SNS, duke përfshirë anëtarët e familjes, të kenë informacion se si ata mund të raportojnë keqpërdorimin ose të ndryshojnë përfituesit e ndihmës, për të siguruar që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre. Kjo mund të përfshijë, për shembull, një fushatë informimi duke synuar gratë në veçanti.
- Të vendosen indikatorë dhe të zhvillohen aktivitete specifike për të rritur përqindjen e grave që përfitojnë nga transferet e SNS-së.
- Të bashkëpunohet me OShC-të që punojnë me persona me aftësi të kufizuara, veçanërisht me organizatat e grave, si dhe mediet për të siguruar që familjet me vajza me aftësi të kufizuara të sensibilizohen për të drejtat e fëmijëve të tyre, të cilat kanë të bëjnë me këto përfitime.
- Të rritet me një për qind në vit pjesa e familjeve me vajza që marrin këtë përfitim deri sa të arrijë 50%.
- Të mbledhen dhe të paraqiten të dhëna për gjininë e fëmijëve në strehim familjar dhe në OJQ-të tjera që ofrojnë shërbime sociale, siç është SOS Kinderdorf.
- Të sigurohen fonde të mjaftueshme për SOS Kinderdorf.
- Të planifikohet buxheti për të paktën një strehimore që strehon burrat dhe djemtë mbi moshën 12 vjeç, një strehimore për personat LGBT, dhe një strehimore në veri të Kosovës. Kjo mund të përfshijë kontraktimin e këtyre shërbimeve.
- Të vazhdohet financimi i strehimoreve në bazë të numrit të personave të strehuar. Të bëhen vlerësime të sakta të shpenzimeve të strehimores për person, duke monitoruar me kujdes prirjet në shpenzimet aktuale të ofruara për strehim me kalimin e kohës. Kjo mund ta ndihmojë MPMS-në buxhetimin më të mirë në të ardhmen për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave të cilët kanë përjetuar dhunë.

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës

- Informatat demografike në lidhje me përfituesit e këtyre pensioneve mund të jenë të dobishme për të siguruar që ata të kenë qasje të lehtë në shërbimet që kanë të bëjnë me këto pensione, duke pasur parasysh nevojat e tyre specifike.
- Të merret parasysh ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës për të garantuar pagë të barabartë për punë të barabartë, të kryer nga të gjithë kujdestarët e personave që kanë pësuar lëndime gjatë luftës.

Hyrje

Burrat dhe gratë kanë prioritete, interesa, dhe nevoja të ndryshme. Përtej dallimeve gjinore, mund të ndryshojnë edhe nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave të ndryshëm. Për shembull, banorët e fshatrave mund të kenë nevoja që ndryshojnë nga nevojat e personave që jetojnë në qytete; nevojat e grave të reja ndryshojnë nga ato të burrave më të vjetër; nevojat e personave të papunë ndryshojnë nga ato të personave të punësuar; personat e grupeve etnike të ndryshme mund të hasin në probleme të ndryshme. Pasi që qeveria është krijuar për të hartuar politika nga të cilat do të përfitojnë qytetarët e saj të ndryshëm, buxhetet qeveritare duhet të sigurojnë që nevojat e ndryshme të qytetarëve të ndryshëm të merren parasysh dhe të trajtohen gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) mund ta bëjë planifikimin dhe ekzekutimin e buxheteve të qeverisë më efektiv, efikas, transparent, dhe të barabartë. BPGj-ja përfshin integrimin e perspektivës gjinore në proceset dhe dokumentet buxhetore dhe kërkon një analizë të ndikimit potencialisht të ndryshëm që shpenzimet e planifikuara dhe burimet e alokuara kanë te burrat dhe gratë. Përtej dallimeve gjinore, buxhetet duhet të kujdesen për nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave të *ndryshëm*, të referuar në këtë raport si “Gjinia⁺”. Kjo përfshin analizimin lidhur me atë se deri në çfarë mase shërbimet qeveritare dhe përfitimet i plotësojnë nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm, të moshave të ndryshme, etnive, dhe dallimet tjera relevante demografike.

Që nga viti 2015, një kornizë e fuqishme ligjore në Kosovë i obligon organizatat buxhetore që të bëjnë BPGj. Ligji i ri për Barazi Gjinore përkufizon BPGj-në si:

Buxhetimi gjinor - është zbatimi i integritetit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së grave dhe burrave.¹

Më tej, neni 5.1.5, i obligon të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës ta përfshijnë “buxhetimin gjinor në të gjitha fushat, si një instrument të nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve”.² Përveç kësaj, Qarkorja Buxhetore 2016/02, e nxjerrë nga Ministria e Financave, që përdoret për të informuar organizatat buxhetore për strukturën e shpenzimeve për vitin e ardhshëm, siguroi mostrat e tabelave që duhet të plotësohen nga të gjitha ministritë³ dhe komunat.⁴ Kështu, tashmë ekziston një kornizë mjaft e fuqishme ligjore për institucionalizimin e BPGj-së në Kosovë. Gjithashtu, nëpërmjet trajnimit dhe stërvitjes, shumë zyrtarë kanë qenë të ekspozuar ndaj buxhetimit gjinor qoftë si koncept, qoftë si mjet praktik.

Në mesin e ministrive në Kosovë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përvojën më të gjatë me buxhetimin gjinor. Në vitin 2014, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)* dhe MPMS-ja bashkëpunuan në analizimin e të dhënave të MPMS-së nga një perspektivë e BPGj-së dhe përdorimin e tyre për planifikimin e buxhetit. Në vitin 2015, duke u mbështetur në këtë bashkëpunim pozitiv, partnerët e zgjeruan këtë analizë në Analizën Gjinore⁺, ku është përfshirë ekzaminimi i ndarjeve buxhetore për gratë dhe burrat të moshave, etnive, dhe zonave gjeografike të ndryshme. Kjo analizë kishte për qëllim të mbështesë programe si dhe shpenzime më të mirë-informuara dhe më specifike ndaj grupeve të synuara, që plotësojnë nevojat potencialisht të ndryshme të qytetarëve të ndryshëm të Kosovës.

Një ekzaminim më i thellë i kategorive të tjera demografike mund të vërë në dukje zonat potenciale të përjashtimit dhe marginalizimit social. Ky raport vlerëson se kush ka përfituar nga

¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, 2015, marrë nga:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20sh.pdf>, Neni 3.1.17.

² Ligji për Barazi Gjinore, Art. 5.1.5.

³ Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, Qarkorja Buxhetore 2015/02 për Ministritë, 2015, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret>.

⁴ Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, Qarkorja Buxhetore 2015/02 për Komunat, 2015, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore>.

shërbimet dhe programet e MPMS-së në të kaluarën, krahason përfituesit aktualë me grupet e synuara dhe ata që kanë më së shumti nevojë për shërbime të tilla, dhe përdor këto informata për të dhënë rekomandime në lidhje me shpenzimet e ardhshme të planifikuara.

Raporti fillon me një pasqyrë demografike në Kosovë, e cila është e nevojshme për identifikimin e nevojave. Më pas, paraqet analizën Gjinore⁵ të departamenteve dhe divizioneve të ndryshme të MPMS-së, buxheteve të tyre dhe përfituesve. Fokusi bie mbi atë se si kanë përfituar grupet e synuara nga shërbimet, subvencionet dhe transferet e MPMS-së. Ky raport shqyrton vetëm dy kategori të shpenzimeve (pagat dhe mëditjet; subvencionet dhe transferet), sepse këto janë ndoshta më të rëndësishme në aspektin e përfituesve dhe grupeve të synuara. Kjo për arsye se aktualisht nuk ka të dhëna të mjaftueshme të ndara sipas gjinisë për një analizë të detajuar të kategorive të tjera të shpenzimeve. Të gjitha të dhënat janë siguruar nga departamentet dhe divizionet përkatëse të MPMS-së, përveç nëse tregohet ndryshe në këtë raport. Kështu, të gjitha parashikimet për vitet e ardhshme të paraqitura brenda tabelave janë bërë nga departamentet dhe divizionet përkatëse në kuadër të Ministrisë.

Rekomandimet e bazuara në dëshmi janë paraqitur për secilin departament dhe divizion me qëllim të shpenzimeve më efektive dhe efikase që ndihmojnë barazinë gjinore, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Kjo përfshin identifikimin e objektivave specifike, treguesve dhe aktivitetet ku ato ekzistojnë për avancimin e barazisë gjinore dhe për shpenzime më specifike për grupet e ndryshme demografike të synuara brenda çdo departamenti dhe divizioni.

Të dhënat kryesore demografike për të ofruar informata për analizën gjinore

Për të vlerësuar shkallën në të cilën shërbimet dhe shpenzimet e MPMS-së kanë adresuar nevojat e grupeve të ndryshme demografike, duhet të dimë përbërjen demografike të popullsisë së synuar. Nga përafërsisht 1,739,825 qytetarë të Kosovës, në vitin 2011, 49.6% ishin gra dhe 50.3% burra. Përsa i përket vendndodhjes gjeografike, 38% e kosovarëve jetonin në zonat urbane dhe 62% në zonat rurale. Përqindja e grave dhe burrave që jetojnë në zonat rurale dhe urbane ishte mjaft e ngjashme.⁵ Madhësia e popullsisë së Kosovës pritet të rritet midis viteve 2013 dhe 2018, por raporti gjinor pritet të mbetet i ngjashëm (shih tabelën 1).⁶

Siç ilustron Tabela 2, burrat shqiptarë përbëjnë 93% të të gjithë burrave që jetojnë në Kosovë, burra serbë 1.4%, burra turq 1%, burra boshnjakë 1.5%, burra romë 0.5%, burra ashkali 0.9%, dhe burra egjiptianë 0.6%. Gratë shqiptare përbëjnë 92.8% të të gjitha grave, ato serbe 0.7%, gratë turke 1%, gratë boshnjake 0.5%, gratë rome 0.5%, gratë

Tabela 1. Parashikimi i popullsisë në Kosovë 2013-2018 sipas gjinisë

Viti	Total	Burra	Gra
2013	1,805,853	909,523 (50%)	896,329 (50%)
2014	1,816,891	915,395 (50%)	901,496 (50%)
2015	1,827,231	921,133 (50%)	906,098 (50%)
2016	1,836,978	926,829 (50%)	910,149 (50%)
2017	1,847,632	932,447 (50%)	915,185 (50%)
2018	1,857,867	937,950 (50%)	919,917 (50%)

Tabela 2. Përbërja etnike e Kosovës në vitin 2011 sipas gjinisë

Përkatësia etnike	Të gjithë	% sipas gjinisë së etnive		% e popullsisë së Kosovës		Të gjitha grupet etnike
		Burra	Gra	Burra	Gra	
Shqiptarë	1,616,869	50%	50%	47%	46%	93.00%
Serbë	25,532	51%	49%	0.75%	0.72%	1.47%
Turq	18,738	50%	50%	0.50%	0.50%	1.0%
Boshnjakë	27,533	48%	52%	0.80%	0.80%	1.60%
Romë	8,824	50%	50%	0.30%	0.80%	1.1%
Ashkali	15,436	51%	49%	0.50%	0.50%	0.90%
Egjiptianë	11,524	50%	50%	0.30%	0.30%	0.60%
Goranë	10,265	50%	50%	0.30%	0.30%	0.60%

⁵Sipas të dhënave të regjistrimit, 38.3% e grave jetojnë në zonat urbane dhe 61.6% në zonat rurale; 37.7% e burrave jetojnë në zonat urbane dhe 62.2% në zonat rurale.

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Parashikimi i Popullsisë së Kosovës 2011-2061, 2013, e disponueshme marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/KOSOVO%20POPULATION%20PROJECTION%202011-2061.pdf>.

ashkali 0.8% dhe gratë egjiptase 0.6%. Për shkak të pjesëmarrjes së ulët të serbëve në regjistrimin e popullsisë, është vlerësuar se në veri të Kosovës jetojnë serbë të tjerë.⁷ Megjithatë, në përputhje me legjislacionin e Kosovës, të diskutuara në disa raste në këtë raport, ata kanë prirjen të mos kenë të drejtë në shërbimet e Kosovës në qoftë se nuk janë të regjistruar si qytetarë të Kosovës. Prandaj, të dhënat e regjistrimit përdoren për të llogaritur përqindjet e popullsisë.

Mosha mund të jetë një kategori e rëndësishme demografike në shqyrtimin e subvencioneve të ndihmës sociale, duke përfshirë edhe pensionistët. Në Kosovë, në vitin 2011, fëmijët deri në moshën nëntë vjeçare përbënin afërsisht 18% të popullsisë (shih Tabelën 3), 52% prej të cilëve ishin djem dhe 48% vajza. Personat e moshës 10-19 vjeçare përbënin 20% të popullsisë, 52% djem/burra dhe 48% vajza/gra. Personat e moshës 19-39 vjeçare përbënin 32% të popullsisë, me një raport gjinor prej 50%. Personat e moshës 39-64 vjeçare përbënin 27% të popullsisë, 43% burra dhe 57% gra. Personat me moshë nga 65 vjeç e sipër përbënin 12% të popullsisë, dhe kjo kategori e moshës ishte 53% gra dhe 47% burra.

Tabela 4 përmbledh numrin e përafërt të personave që kanë lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara në Kosovë, duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011. Gratë përbënin rreth 53.5% të personave me aftësi të kufizuara, ndërsa burrat përbënin 46.5%.

Tabela 3. Popullsia e Kosovës sipas Grupmoshës dhe Gjinisë në vitin 2011

Grup mosha	E përgjithshme	E përgjithshme %	% burra	% gra
0-9	310,651	17.9%	52%	48%
10-19	351,858	20.2%	52%	48%
19-39	558,189	32.1%	50%	50%
39-64	472,948	27.2%	43%	57%
65+	207,691	12.0%	47%	53%

Tabela 4. Numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë

Lloji i aftësisë së kufizuar	Burra	% Burra	Gra	% Gra	I përgjithshëm
Shurdhimi apo dëmtim i rëndë i dëgjimit	5,252	52.86%	4,683	47.13%	9,935
Verbëria apo dëmtimi i rëndë i të parit	4,647	49.25%	4,788	50.75%	9,435
Kufizime thelbësore në veprimtaritë themelore fizike siç janë ecja, ngjitja, ngritja e objekteve, etj	14,577	46.17%	16,990	53.82%	31,567
Mësimnxënia ose paaftësia intelektuale	2,641	47.10%	2,966	52.89%	5,607
Vështirësia psikologjike ose emocionale	4,217	51.85%	3,916	48.15%	8,133
Të tjera, duke përfshirë çfarëdo sëmundje afatgjatë	12,044	42.09%	16,567	57.90%	28,611

Përgjegjësitë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

MPMS-ja ka përgjegjësi që të sigurojnë mirëqenien sociale të qytetarëve në Kosovë. Përgjegjësitë dhe kompetencat e saj ndër të tjera përfshijnë:

- Zhvillimin e politikave lidhur me mirëqenien sociale, sigurimin dhe monitorimin e zbatimit të tyre
- Promovimin dhe mbështetjen e punësimit
- Identifikimin dhe adresimin e nevojave për ndihmë sociale të qytetarëve
- Mbrojtjen e familjeve dhe të miturve përmes programeve për mirëqenie sociale⁸

Me qëllim të zbatimit të përgjegjësisë së saj, MPMS-ja ka krijuar një Strategji Sektoriale e cila ka katër Objektiva Strategjike:

⁷ Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), 22,530 serbë jetojnë në Mitrovicën e Veriut, 18,000 në Leposaviq, 16,000 në Zveçan, si dhe 13,900 në Zubin Potok, që arrin në numrin e përgjithshëm në 70,430 vetëm në veri.

⁸ Qeveria e Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2012 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë, 2011, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miratuar nga_Qeveria-finale.pdf, Shtojca 10.

- **Objektivi Strategjik 1:** Rritja e punësimit, zhvillimi i aftësive dhe sigurimi/themelimi/puna në funksionim më të mirë të tregut të punës
- **Objektivi Strategjik 2:** Përmirësimi i mirëqenies sociale, përmes rritjes së cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare, me një fokus të veçantë në grupet e marginalizuara
- **Objektivi Strategjik 3:** Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të pensioneve dhe rritja e kapaciteteve institucionale për realizimin e të drejtave dhe përfitimeve të shërbimeve më të mira për pension të pleqërisë dhe pensionet në lidhje me luftë.
- **Objektivi Strategjik 4:** Fuqizimi i rolit të partnerëve socialë në zhvillimin e politikave sociale-ekonomike, përmirësimi i mjedisit të punës të të punësuarve dhe rënia e punësimit informal.⁹

Për të arritur këto objektiva, është i rëndësishëm analizimi i nevojave të këtyre grupeve të ndryshme të synuara. Një analizë e tillë duhet të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore lidhur me të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe BPGj-së.

Divizioni për Burime Njerëzore

Divizioni për Burime Njerëzore, midis përgjegjësive të tjera, administron rekrutimin e stafit, përmirëson shkathtësitë dhe trajnimin e stafit; dhe koordinon planifikimin e burimeve njerëzore.¹⁰ Të dhënat nga Divizioni për Burime Njerëzore janë të dobishme për ofrimin e informatave për BPGj-në, lidhur me kategorinë e buxhetit për shpenzimet për paga dhe mëditje.

Tabela 5 tregon se ndërsa gratë përbëjnë shumicën e personave të punësuar nga MPMS-ja në nivele të ulëta në shkallës së pagës, burrat janë të punësuar në nivel shumë më të lartë dhe kanë nivele më të larta të pagave.¹¹ Një përmirësim i lehtë mund të vërehet në krahasim me vitin 2014, kur asnjë grua nuk ishte punësuar në nivelin e pagave 600+ €. ¹² Megjithatë, burrat ende marrin shumicën dërrmuese të shpenzimeve nga kjo kategori e shpenzimeve, dhe përqindja e grave në pozita vendimmarrëse (19%) nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit të ri për Barazi Gjinore (50%).

Tabela 6 tregon se shumica e punonjësve në MPMS kanë qenë burra shqiptarë (48% në 2013-2014). Kjo përqindje rritet në 55% në vitin 2015. Gratë shqiptare përbënin 42% deri 46% të të punësuarve nga viti 2013 deri në vitin 2015. Në vitin 2013 dhe 2014, gratë shqiptare ishin pak të nën-përfaqësuar pasi ato përbënin 46% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Grupet e pakicave etnike duket të jenë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në kuadër të MPMS-së sipas përqindjes së tyre në popullsinë e Kosovës. Kjo mund të kontribuojë në sigurimin që interesat e grave dhe burrave të ndryshëm në Kosovë të merren parasysh në politikat dhe programet e MPMS-së.

Tabela 5. Nivelet e shkallës së pagave të MPMS-së sipas gjinisë, 2015

Niveli i pagës	Burra	Gra	Total	%Burra	%Gra
201-400€	186	218	404	46%	54%
401-600€	266	190	456	58%	42%
600+ €	21	5	26	81%	19%

Tabela 6. Numri i përqindjeve të të punësuarve të MPMS-së, sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike në vitin 2015

Viti	I përgj.	Shq. b.	Shq. %	Shq. g.	Shq. %	Serbë b.	Serbë %	Serbë g.	Serbë %	Romë b.	Romë %	Të tjerë burra	Të tjerë %	Të tjerë gra	Të tjerë %
2013	1,013	483	48%	426	42%	48	5%	35	3%	1	0.1%	3	0.3%	17	2%
2014	978	471	48%	411	42%	34	3%	40	4%	5	0.5%	2	0.2%	15	2%
2015	794	436	55%	358	45%	32	4%	38	5%	5	0.6%	2	0.3%	15	2%

⁹ Përkthyer dhe përshtatur nga MPMS-ja, *Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2014-2020*, Prishti marrë nga: 2014.

¹⁰ Qeveria e Kosovës, faqja e internetit e MPMS-së, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/en-us/departments/departments/departmentoffinanceandgeneralservices/humanresourcesdivision.aspx>.

¹¹ Për fat të keq Divizioni nuk ka ofruar të dhëna në lidhje me shumatat aktuale të marra nga gratë dhe burrat, edhe pse këto të dhëna ekzistojnë.

¹² RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, Prishti marrë nga: 2014, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20140702111943317.pdf>.

Gjetjet kryesore

- Pavarësisht përmirësimeve që nga viti 2014, gratë shqiptare mbeten të nën-përfaqësuar në MPMS, veçanërisht në nivelet e vendimmarrjes dhe për sa u takon shkallëve më të larta të pagës. Burrat janë fare pak të nën-përfaqësuar në nivelet e shkallëve të ulëta të pagave.

Rekomandimet

- Të vazhdohet rritja e përqindjes së grave të punësuar në nivele më të larta në shkallëve të pagës çdo vit derisa të arrihet kërkesa ligjore e punësimit të grave prej 50% në të gjitha nivelet e pagës. Kjo mund të arrihet kur vendet e punës hapen përmes veprimeve afirmative në procedurat e punësimit, siç është paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore.
- Të analizohen të dhënat gjinore të të punësuarve të MPMS-së, të ndara sipas gradës dhe nivelit të pagës për çdo vit

Sistemi Pensional në Kosovë

I hartuar në vitin 2003, sistemi aktual pensional i Republikës së Kosovës ka tri shtylla: i) pleqëria “pensioni themelor” dhe pensioni invalidor; II) pensioni i detyrueshëm kontribut-pagues; dhe III) skema të tjera vullnetare.¹³ Kjo analizë fokusohet në dy shtyllat e para, për të cilat Qeveria e Kosovës ka një përgjegjësi buxhetore.¹⁴

Pensioni bazë

Ligji Nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës e definon “Pensionin Bazë” si “një pension që Administrata Pensionale ua paguan të gjithë banorëve të përhershëm të Kosovës që e kanë arritur moshën e pensionimit.”¹⁵ Kështu, të gjithë qytetarët e Republikës (gratë dhe burrat) të cilët janë mbi moshën 65 vjeçare kanë të drejtë në këtë pension. Ky pension nuk është i lidhur me kontributet e mëparshme në sistemin e pensioneve. Administrata Pensionale e Kosovës (AKP) është përgjegjëse për administrimin e këtij pensioni përmes transfereve mujore të parave.

Shuma e pensionit bazë të shpërndarë për person duhet të caktohet në vit, në përputhje me sasinë e nevojshme për konsum minimal sipas shportës ushqimore mujore.¹⁶ Çdo shumë më pak se kjo, do t'i vendoste pensionistët në rrezik nga varfëria. Tabela 7 tregon se nga viti 2011 deri në vitin 2015, pensioni bazë mujor ka ndryshuar, duke përfshirë edhe parashikimet e qeverisë për 2016-2018. Kjo tregon se pensioni i shpërndarë për person në muaj në vitet 2011-2013 nuk ka qenë në përputhje me shportën minimale të mallrave (63 € në vitin 2012). Megjithatë, në vitin 2014, pensionet janë rritur deri 75 € në muaj. Ndërkohë që kjo është më shumë sesa

Tabela 7. Pensionet Mujore Bazë 2011-2018		
Viti	Pensioni mujor	Buxheti vjetor i ndarë për pensionet bazë
2011	45€	n/a
2012	50€	n/a
2013	60€	87,340,090€
2014	75€	108,312,220€
2015	74€	119,083,714€
2016	74€	123,480,000€
2017	74€	134,602,500€
2018	74€	128,955,000€

¹³ Grupi për Studime Juridike dhe Politike, *Sistemi i pensioneve në Kosovë: Shqyrtimi i gjendjes aktuale, sfidat dhe mangësitë kryesore*, Prishti marrë nga: 2012, marrë nga:

<http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy%20Report%2006%202012%20eng.pdf>.

¹⁴ Shtylla e tretë përfshinë skemat vullnetare private të pensioneve të cilat i nënshtrohen licencimit nga Banka Qendrore e Kosovës.

¹⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-101, 2012, marrë nga:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Pension%20Funds%20of%20Kosovo.pdf>.

¹⁶ Banka Botërore, *Reforma Pensionale e Kosovës: Arritjet dhe Mësimet 2007*, në: <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf> dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike, *Sistemi Pensional në Kosovë*, f. 7.

minimumi i shportës ushqimore, do të ishte shumë e vështirë që një person të jetojë në mënyrë të pavarur dhe të ketë strehim me këtë shumë të të hollave. Kështu, personat e moshuar që marrin këtë pension kanë të ngjarë që ende të varen nga anëtarët e tjerë të familjes në mënyrë që të mbijetojnë.

Në vitin 2014,¹⁷ buxheti i përgjithshëm për pensionet bazë ishte 108.312.220 €. Nga kjo, gratë morën 77.547.060 € (71.6%), ndërsa burrat 30.765.160 € (28.4%). Më tej, Tabela 8 tregon se vazhdimisht më shumë gra sesa burra kanë përfituar nga pensionet bazë. Përafërsisht, 65% e subvencioneve të pensionit bazë u janë shpërndarë grave dhe 35% burrave. Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011, tregojnë se ka më shumë gra mbi moshën 65 vjeç sesa burra. Edhe pse ndodh kështu, shumica e pensionit bazë të shpenzuar për gra (65%) arrijnë më shumë se përqindja e tyre e popullsisë (53%). Ndryshimi në përfitime ndoshta mund t'i atribuohet faktit se historikisht në Kosovë kanë punuar më pak gra sesa burra. Prandaj, për Pension Kontribut-pagues më shumë kualifikohen burrat (shih më poshtë) sesa gratë. Si rezultat, më shumë gra sesa burra marrin pensionin bazë.

Tabela 8 ilustron gjithashtu se ka një ndryshim në përqindjen e përfituesve sipas gjinisë, në krahasim me përqindjen e shpenzimeve për personat e asaj gjinie. Për shembull, në vitin 2015, burrat përbëjnë 32% të përfituesve, por kanë marrë 44% të shpenzimeve. Sipas MPMS-së, ky ndryshim është për shkak të pensioneve retroaktive.¹⁸ Për shembull, në qoftë se një person aplikon për t'u bërë përfitues pensioni, procedura për shqyrtimin e kërkesës merr të paktën 90 ditë për t'u miratuar, por parashtruesi më pas në mënyrë retroaktive merr pensionin për periudhën gjatë së cilës kërkesa është shqyrtuar.

Viti	Përfituesit	Buxheti total	Burra	€ të shpenzuara për burra	Gra	€ të shpenzuara për gra
2013	117,042	87,340,090	51,954 (35%)	30,769,200 (35%)	76,418 (65%)	56,570,890 (65%)
2014	125,883	108,312,220	43,839 (32%)	30,765,160 (28%)	82,044 (68%)	77,547,060 (72%)
2015	132,383	118,028,580	46,772 (32%)	52,311,782 (44%)	85,611 (68%)	65,716,798 (56%)
2016	139,100	123,480,000	49,526 (33%)	54,496,082 (44%)	89,574 (67%)	68,983,918 (56%)
2017	145,200	128,955,000	51,954 (33%)	56,888,796 (44%)	93,246 (67%)	72,066,204 (56%)
2018	151,500	134,602,500	55,358 (33%)	59,564,691 (44%)	96,142 (67%)	75,037,809 (56%)

Parashikimet e bëra nga MPMS-ja për vitet e ardhshme tregojnë se numri i përfituesve të pensionit bazë do të rritet gradualisht, njëllëj sikurse edhe buxheti shoqëruar i përgjithshëm. Megjithatë, shumica e pensionit të marrë për person (përafërsisht 888 € në vit) dhe përqindja e përfituesve që janë gra (67%) dhe burra (33%) janë planifikuar të mbeten të pandryshuara.

Deri më sot, përqindja e pensioneve bazë të marra nga burrat shqiptarë ka qenë 25% në vitin 2015, 51% janë marrë nga gratë shqiptare, 11% nga burrat jo-shqiptarë, dhe 13% nga gratë jo-shqiptare. Gjithsej 29,918 persona të përkatësive etnike jo-shqiptare kanë marrë pensione bazë në vitin 2014 (shih Tabelën 9), duke përfshirë 44.5% burra dhe 55.4% gra. MPMS-ja aktualisht nuk mban të dhëna të ndara sipas përkatësisë etnike për grupet e ndryshme etnike jo-shqiptare apo sipas lokacionit gjeografik.¹⁹

¹⁷ Ky është viti më i fundit për të cilin ka të dhëna të plota të disponueshme. Ndërsa të dhënat ekzistojnë për vitin 2015, ato përfshijnë vetëm gjashtë muajt e parë të vitit.

¹⁸ 2015. RrGGK bisedë, 2015.

¹⁹ KWN Bisedë e RrGGK me Departamentin, 2015; dhe evidente në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), *Statistikat e Mirëqenies Sociale Q2*, Prishtinë marrë nga: ASK, 2015, marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/ENG/social-welfare-and-literacy/publications>.

Tabela 9. Pensioni bazë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike					
Viti	Përfituesit e pensionit bazë	Shqiptarë burra	Shqipëtare gra	Burra jo-shqiptarë	Gra jo-shqiptare
2013	117,042	28,574 (24%)	61,099 (52%)	12,050 (10%)	15,319 (13%)
2014	125,883	30,509 (24%)	65,456 (52%)	13,330 (11%)	16,588 (13%)
2015	132,383	32,504 (25%)	68,055 (51%)	14,268 (11%)	17,556 (13%)
2016	139,100	34,158 (25%)	70,218 (50%)	15,368 (11%)	19,356 (14%)
2017	145,200	35,028 (24%)	71,987 (50%)	16,926 (12%)	21,259 (15%)
2018	151,500	37,119 (25%)	73,350 (48%)	18,239 (12%)	22,792 (15%)

Gjetjet kryesore

- Më shumë gra se burra marrin pensione bazë.
- MPMS-ja aktualisht nuk mban të dhëna të ndara sipas të gjitha përkatësive etnike dhe vendndodhjes gjeografike.

Rekomandimet

- Të mbahen të dhëna të ndara sipas gjinive dhe të gjitha përkatësive etnike.
- Verifikimi i numrit dhe përqindjes së përfituesve sipas përkatësisë etnike me anë të regjistrimit dhe të dhënave demografike mund ta lehtësojë “pastrimin” e listave të pensioneve. Kjo mund të sigurojë fonde të mjaftueshme për rritje të pensioneve bazë, pa pasur nevojë për ndonjë rritje të shpenzimeve, nëpërmjet shpenzimit më efikas.

Pensioni kontribut-pagues

Programi i pensioneve kontribut-paguese kërkon që të gjithë banorët e përhershëm të Kosovës, të cilët punojnë, të kontribuojnë me 5% të pagës së tyre bruto në Trustin Pensional dhe 5% shtesë paguhet nga punëdhënësi.²⁰ Punonjësit mund të zgjedhin të paguajnë një shtesë prej 5% në baza vullnetare, duke shtuar maksimumi deri në 15%. Përveç kësaj, punëdhënësit mund të kontribuojnë 10% më shumë, duke shtuar maksimumi 15%. Personat që kanë kontribuar më shumë për Trustin Pensional kualifikohen për rritjen e shumave të pensionit pas daljes në pension. Kështu, përqindja e përfituesve të pensioneve sipas gjinisë mund të ndryshojë në krahasim me përqindjen e shpenzimeve për përfituesit bazuar në pagat dhe pagat shtesë të bëra më herët gjatë jetës.

Çdo vit shuma e pensioneve kontribut-paguese është rritur pak, dhe shuma është planifikuar të rritet me një euro në vit nga 2016-2018 (shih Tabelën 10).

Tabela 11 tregon shpenzimet e planifikuara për 2016-2018 bazuar në Projektligjin për Buxhetin 2016.²¹ MPMS-ja ka buxhetuar në mënyrë adekuate një rritje të planifikuar prej 23 € milion për rritjen e pensioneve kontribut-pagues në vitin 2016. Kjo rritje vlen vetëm për Pensionet kontribut-pagues dhe jo për pensionet bazë. Kjo është shqetësuese pasi që përfituesit e pensionit bazë, kryesisht gra, tashmë

Tabela 10. Pensioni vjetor për person	
Viti	€
2013	1,372
2014	1,601
2015	1,690
2016	1,659
2017	1,660
2018	1,661

²⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2009, për rritjen e pensioneve për zbatimin e vendimit të qeverisë nr 02/51, shtator 2009, neni 4, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.15-2009%20Për%20Rritjen%20e%20pensioneve%20për%20zbatimin%20e%20Vendimit%20të%20Qeverisë%20Nr.02-51.pdf>.

²¹ Ministria e Financave, Projektligji për Buxhetin 2016, 2015, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/en-us/Budget/Budget-of-Republic-of-Kosovo/Central-Budget>.

marrin më pak se personat që marrin pension kontribut-pagues. Më tej, MPMS-ja ka buxhetuar që kjo rritje të ndodhë vetëm në vitin 2015. Tabela 11 tregon se pensioni kontribut-pagues mund të zvogëlohet përsëri që nga viti 2017.

Rritja prej 23 milion € për pensionet kontribut-pagues, e vendosur më pas në nëntor 2015 dhe reflektuar në projekt-buxhetin e vitit 2016, nuk është pasqyruar në parashikimet fillestare të përfituesve dhe të buxhetit që MPMS-ja fillimisht kishte siguruar në tetor (shih Tabelën 12). Megjithatë, kjo informatë është paraqitur ashtu siç është marrë nga MPMS-ja, sepse ajo përmban parashikime lidhur me numrin dhe përqindjet e përfituesve sipas gjinisë. Me sa duket, numri dhe përqindjet e përfituesve do të mbeten ashtu siç janë planifikuar në fillim.

Numri i përfituesve të pensioneve kontribut-pagues është rritur vazhdimisht, siç ilustron në Tabelën 12.

Tabela 11. Shpenzimet aktuale dhe të planifikuara për pensionet kontribut-pagues

Viti	Subvencionet dhe transferet
2014	47,897,475€
2015	68,633,800€
2016	91,683,800€
2017	84,073,874€
2018	89,073,874€

Tabela 12. Përfituesit e pensioneve kontribut-paguese sipas gjinisë

Viti	Përfituesit e pensioneve	Buxheti total	Burra	€ për burra	Gra	€ për gra
2013	36,015	49,412,649	32,050 (89%)	43,836,297 (89%)	3,965 (11%)	5,576,352 (11%)
2014	38,651	61,895,592	34,159 (88%)	54,111,132 (87%)	4,492 (12%)	7,784,460 (13%)
2015 (shtat.) ²²	40,600	68,633,800	35,333 (87%)	39,436,103 (57%)	5,267 (13%)	5,355,880 (8%)
2016	43,300	71,827,000	36,498 (84%)	53,347,438 (74%)	6,802 (16%)	18,479,562 (26%)
2017	45,300	75,180,000	37,698 (83%)	55,169,524 (73%)	7,602 (17%)	20,010,476 (27%)
2018	47,300	78,547,000	39,335 (83%)	56,676,331 (72%)	7,965 (17%)	21,870,669 (28%)

Burrat përbëjnë shumicën e përfituesve të pensioneve kontribut-dhënëse (87-89% në 2013-2015). Ky dallim mund t'i atribuohet përqindjes më të lartë të burrave që kanë punuar, veçanërisht gjatë 15 viteve para vitit 1999, në krahasim me gratë. Pjesëmarrja e fuqisë punëtore të grave ishte nën 18% në vitin 1960, pasuar me një rritje të lehtë prej 20-21% në vitet '70, dhe arriti kulmin e saj në vetëm 23% në vitin 1988.²³ Kështu, pak gra pensioniste marrin pensione kontribut-paguese për shkak se pak gra punonin. Më tej, zyrtarët e MPMS-së kanë vënë në dukje se shumica e grave që kanë punuar gjatë kësaj periudhe kanë qenë serbe dhe janë larguar nga Kosova që prej atëherë.²⁴ Përkundër kësaj, pjesëmarrja e burrave në këtë pensioni parashikohet të ulet hap pas hapi gjatë tri viteve të ardhshme. Rritja e parashikuar është e lidhur me miratimin e parashikuar të Ligjit për Statusin e Punëtorëve të sektorit të arsimit në vitet 1990. Ai do t'u sigurojë pensione në mënyrë retroaktive kryesisht grave dhe burrave shqiptarë, të cilët kanë dhënë mësim nga viti 1989 deri më 1999, por kontributi i të cilëve nuk është regjistruar zyrtarisht. Statistikat MASH-it tregojnë se shumica e këtyre mësuesve ishin gra, të cilat do të kontribuojnë në pjesën e projektuar të rritur të grave që marrin pensione kontribut-dhënëse.

²² Posaqërisht shuma e përgjithshme e shpërndarë deri me tani për gratë dhe burrat nuk shtohet në buxhetin total, sepse në këtë tabelë përfshihen vetëm shumat e shpërndara që nga shtatori 2015.

²³ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, 2014.

²⁴ Po aty.

Tabela 13 ilustron numrin dhe përqindjen e përfutuesve të pensioneve kontribut-paguese sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë. Pa statistika më të mira demografike është e vështirë të vlerësohet nëse kjo pasqyron përqindjen e grave dhe burrave që do të kualifikohen për pensione kontribut-paguese. Megjithatë, në aspektin e popullsisë së përgjithshme të Kosovës, pensione kontribut-paguese ka marrë një përqindje pak më e lartë e burrave jo-shqiptarë (2% në krahasim me 1.4% të popullsisë) dhe një përqindje pak më e ulët e grave jo-shqiptare (0.6% në vitin 2014, krahasuar me 0.7% të popullsisë në vitin 2011).²⁵ Nuk ka pasur në dispozicion të dhëna të ndara sipas përkatësisë etnike për grupe të ndryshme etnike, pasi ato aktualisht nuk mbahen nga MPMS-ja.²⁶

Tabela 13. Përfutuesit e pensioneve kontribut-paguese sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Përfutuesit e pensionit	Shq. Burra	Shq. Gra	Jo-shq. Burra	Jo-shq. gra
2013	36,015	31,347 (87%)	3,845 (11%)	703 (2%)	120 (0.3%)
2014	38,651	33,459 (87%)	4,367 (11%)	700 (2%)	125 (0.3%)
2015	40,600	34,526 (85%)	5,035 (12%)	807 (2%)	232 (0.6%)
2016	43,300	35,301 (82%)	6,230 (14%)	1,197 (3%)	572 (1.3%)
2017	45,300	36,351 (80%)	6,880 (15%)	1,347 (3%)	722 (1.6%)
2018	47,300	37,283 (79%)	7,148 (15%)	2,052 (4%)	817 (1.7%)

Gjetjet kryesore

- Gratë vazhdimisht përfitojnë më pak nga pensionet kontribut-paguese sesa burrat, sepse ato kishin më pak mundësi të punësoheshin gjatë viteve të tyre të moshës së punës.

Rekomandimet

- Të shqyrtohet rritja e pensioneve bazë dhe jo vetëm e pensioneve kontribut-paguese, në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës së personave të moshuar të cilët varen nga ky pension, veçanërisht grave.
- Të ruhen të dhëna të ndara sipas gjinisë për të gjitha grupet etnike.

Pensioni i aftësisë së kufizuar

Kosova i nënshtrohet konventave ndërkombëtare dhe deklaratave për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, përfshirë Deklaratën Universale për Drejtat e Njeriut²⁷ dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.²⁸ Kosova kishte një Plan Kombëtar të Veprimit për Aftësi të Kufizuar për 2009-2011.²⁹ Që nga viti 2013, Kosova ka një strategji dhjetë vjeçare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.³⁰ Pensionet për persona me aftësi të kufizuara në Kosovë janë rregulluar me Ligjin nr. 2003/33 mbi Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar në Kosovë.³¹ Ky ligj ofron “mbështetje financiare personave të rritur të cilët janë me banim të përhershëm

²⁵ Për fat të keq, statistikat demografike të ndara sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe moshës (së bashku) nuk ishin në dispozicion

²⁶ Bisedë e RrGGK me Departamentin, 2015; dhe ASK, *Statistikat për Mirëqenie Sociale Q2*.

²⁷ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, në: <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/index.html>.

²⁸ Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2006, në: <http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml>.

²⁹ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, *Plani Kombëtar i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar për Republikën e Kosovës*, 2009, në: http://www.cooperazioneallosviluppo.esteri.it/pdgcs/italiano/iniziative/pdf/Kosovo_Plan.pdf.

³⁰ Zyra e Kryeministrit, *Strategjia Kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023*, 2013, në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_NACIONALE_PER_TE_DREJTAT_E_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE..._Shq+Ser+Ang.pdf.

³¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr 2003/33 për Pensionet me Aftësi të Kufizuar, 2003, në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_23_en.pdf.

në Kosovë dhe të cilët janë plotësisht dhe përherë me aftësi të kufizuara dhe të paaftë për çfarëdo lloji të punës”.³² Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre kategorizohen në një tjetër skemë pensionale, e cila është detajuar në një pjesë tjetër të këtij raporti. Një person kualifikohet për këtë pension pas diagnozës nga një komision mjekësor. Pensioni i marrë nga personat që nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të aftësisë së kufizuar është në të njëjtën shumë sikurse ajo e pensionit bazë.

Ligji parasheh që përfituesit të jenë në mes të moshës 18 dhe 65 vjeçare. Për këtë skemë pensionale, kualifikohen vetëm personat të cilët janë krejtësisht të paaftë për të punuar. Hulumtimi paraprak i RrGGK-së ka vënë në dukje se kjo politikë nuk arrin të inkurajojë personat me aftësi të kufizuar që të jenë të pavarur. Më tej, shumica minimale e siguruar nënkuptonte se për të mbijetuar personat duhej të mbështeteshin shumë në përkrahjen e familjeve të tyre.³³ Kur personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 65 vjeçare ndalojnë së pranuari, pensionin e aftësisë së kufizuar, ata marrin pensionin bazë të pleqërisë. Në vitin 2015, për shembull, kjo do të thotë se pensioni i tyre vjetor do të reduktohet nga 922 € në 888 €, kur ata e tejkalojnë moshën 65 vjeçare (ose nga 77-74 € në muaj).

Tabela 14. Pensioni Vjetor për Person	
Viti	€
2013	1,164
2014	916
2015	922
2016	923
2017	941
2018	942

Tabela 15 tregon se nga viti 2013 deri në vitin 2015, nga kjo skemë pensionale kanë përfituar pak më shumë burra (51-52%) se sa gra (45-48%). Megjithatë, të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se më shumë gra mund të kenë nevojë për pension me aftësi të kufizuar se sa burra. Përveç kësaj, të gjithë qytetarët që kanë nevojë për pension me aftësi të kufizuar mund të mos jenë duke e marrë atë. Në përgjithësi, 31,567 persona kanë “kufizime të konsiderueshme në aktivitetet themelore fizike të tilla siç ecja, ngjitja, ngritja e objekteve”, 46% e të cilëve janë burra dhe 54% gra. Përqindja e grave (54%), me këtë formë të paaftësisë nuk përputhet me përfituesit aktualë të këtij pensioni (48% e grave).

Tabela 15. Përfituesit e pensioneve për aftësi të kufizuar të ndarë sipas gjinisë					
Viti	Përfituesit e pensioneve	Burra	€ për burra	Gratë	€ për gra
2013	11,748	6,264 (53%)	7,086,118 (50%)	5,476 (47%)	7,165,919 (50%)
2014	18,318	9,541 (52%)	8,859,560 (53%)	8,777 (48%)	7,904,520 (47%)
2015	19,445	10,027 (52%)	6,000,535 (50%)	9,418 (48%)	6,113,640 (50%)
2016	19,500	10,027 (51%)	8,924,723 (50%)	9,473 (49%)	9,075,277 (50%)
2017	19,200	9,876 (51%)	8,956,223 (50%)	9,324 (49%)	9,106,777 (50%)
2018	19,200	9,880 (51%)	8,969,723 (50%)	9,320 (49%)	9,120,277 (50%)

Gjetjet kryesore

- Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se jo të gjithë personat me aftësi “të konsiderueshme” të kufizuar marrin këtë pension.
- Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë edhe se më shumë gra sesa burra kanë aftësi të kufizuara. Gratë mund të mos kenë informata në lidhje me këto përfitime.

Rekomandimet

- Të punohet me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara dhe me mediet për të siguruar që të gjithë të sensibilizohen për të drejtën e tyre për këtë pension, duke iu drejtuar me informata në veçanti grave.
- Të shqyrtohet prezantimi i një politike për shqyrtim parlamentar, e cila do t'u mundësonte personave me aftësi të kufizuar që të vazhdojnë të marrin të njëjtin pension kur arrijnë moshën mbi 65 vjeçare.

³² Po aty, f. I.

³³ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*.

Pensioni i parakohshëm për punëtorët e Trepçës

Ky pension është rregulluar me Udhëzimin administrativ nr. 10/2007 për pensionimin e parakohshëm të punëtorëve të kompleksit "Trepça" dhe minierave të tjera nëntokësore në Kosovë.³⁴ Sipas këtij Udhëzimi administrativ, përfituesit e pensioneve janë personat që kanë punuar në kompleksin "Trepça" dhe minierat e tjera nëntokësore, që janë të moshës 50-65 vjeçare. Minatorët e mëparshëm të cilët janë bërë të paaftë për punë dhe që nuk mund të shërohen me mjekim të mëtejshëm, si dhe ata të cilëve aftësia për punë u është zvogëluar më shumë se 50%, kanë të drejtë në këtë pension.³⁵ Pensioni i Trepçës përfshin një transfer mujor prej 50 € nga Administrata e Pensioneve të Kosovës (APK) deri në vitin 2011. Një rritje prej 20 € është aprovuar që nga viti 2011, duke arritur shumën prej 70 € në muaj.³⁶

Numri i personave që marrin këtë pension pritet të ulet çdo vit (shih Tabelën 16). Për shkak të natyrës së kësaj pune, burrat vazhdimisht kanë përbërë shumicën e përfituesve të pensionit. Në vitin 2014, nga 3,580 përfitues 73% ishin burra shqiptarë, 18% kanë qenë gra shqiptare, 2% ishin burra jo-shqiptarë, dhe 7% ishin gra jo-shqiptare (shih Tabelën 16). Numri dhe përqindja e grave shqiptare dhe jo-shqiptare që marrin pension duket se është në rënje të konsiderueshme nga viti 2014 në vitin 2015. Sipas zyrtarëve të MPMS-së, kjo ndodh për shkak se më shumë gra se sa burra që marrin këtë pension kanë mbushur 65 vjeç kohët e fundit, prandaj në vend të këtij pensioni ata kualifikohen për pension kontribut-dhënës.³⁷

Tabela 16. Përfituesit e pensionit të "Trepçës" sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Përfituesit	Burra Shq.	Shpenzuar Burra shq	Gra. shq.	Shpenzuar Gra shq.	Burra Shq.	Shpenzuar Shq. burra	Jo shq. gra.	Shpenzuar - Jo shq. gra
2013	3,821	2,311 (60%)	1,243,837 (22%)	1,110 (29%)	859,273 (16%)	245 (6%)	2,474,452 (45%)	895 (23%)	955,160 (17%)
2014	3,580	2,607 (73%)	1,979,562 (50%)	655 (18%)	994,173 (25%)	78 (2%)	494,890 (13%)	240 (7%)	490,500 (12%)
2015	3,460	2,962 (86%)	3,206,369 (73%)	282 (8%)	973,964 (22%)	116 (3%)	127,900 (3%)	100 (3%)	78,602 (2%)
2016	3,427	2,947 (86%)	3,632,311 (89%)	272 (8%)	1,130,195 (22%)	112 (3%)	199,094 (5%)	96 (3%)	138,400 (3%)
2017	3,405	2,939 (86%)	3,632,400 (71%)	266 (8%)	1,130,106 (22%)	108 (3%)	199,100 (4%)	92 (3%)	138,394 (3%)
2018	3,405	2,939 (86%)	3,632,400 (71%)	266 (8%)	1,130,106 (22%)	108 (3%)	199,100 (4%)	92 (3%)	138,394 (3%)

Gjetjet kryesore

- Numri dhe përqindja e grave shqiptare dhe jo-shqiptare përfituese të këtij pension ka rënë në mënyrë të konsiderueshme nga viti 2014 në vitin 2015, për shkak se kanë filluar që në vend të tij të marrin pensionet kontribut-dhënës.

Divizioni për Çështje Trashëgimore të Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Pensionet për anëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) rregullohen me Ligjin Nr. 03/L-100.³⁸ Ky pension bazohet në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.³⁹ Përfitues janë ish pjesëtarët e

³⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2007 për pensionet e parakohshme për punëtorët e kompleksit të Trepçës dhe minierave të tjera nëntokësore në Kosovë, 2007, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.10-2007%20On%20Early%20Pension%20for%20Workers%20of%20TREPCA%20Complex.pdf>

³⁵ Po aty, Neni 2.

³⁶ Grupi për Studime Juridike dhe Politike, *Sistemi Pensional në Kosovë*, f. 9.

³⁷ Bisedë e RrGGK, 2015.

³⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03 L-100 Për Pensionet e Pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, 2008, marrë nga: http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=278&lang=en.

TMK-së dhe familjet e tyre. Shuma e pensionit është llogaritur bazuar në pozicionin e mbajtur dhe vitet e shërbimit në TMK.⁴⁰ Pjesa më e madhe e përfituesve të pensioneve kanë qenë burra shqiptarë, përkatësisht për shkak se shumica e personave që kanë shërbyer në TMK ishin burra shqiptarë (shih Tabelën 17).

Tabela 17. Përfituesit e pensionit të TMK-së sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Përfituesit	Shq. B.	% Shq. B.	Shpenzuar Shq. B.	Shq. G.	% Shq. G.	Shpenzuar Shq. G.	Jo-shq. B.	% jo-shq. B.	Shpenzuar jo-shq. B.	Jo-shq. G.	% jo-shq. G.	Shpenzuar jo-shq. G.
2013	801	760	95%	1,703,503	32	4%	57,752	6	1%	12,564	3	0%	7,092
2014	844	794	94%	2,099,727	41	5%	90,852	6	1%	15,708	3	0%	6,708
2015	922	844	92%	1,935,656	49	5%	201,684	16	2%	191,128	13	1%	94,800
2016	1,109	951	86%	2,443,757	102	9%	411,751	31	3%	270,760	25	2%	99,332
2017	1,195	987	83%	2,636,557	129	11%	479,351	46	4%	328,360	33	3%	126,932
2018	1,262	1,029	82%	2,767,947	136	11%	514,961	55	4%	353,360	42	3%	134,932

Pensionet për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ligji Nr 04/L-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) e rregullon këtë pension.⁴¹ Anëtarët e FSK-së kanë të drejtë për pension, nëse kanë shërbyer në FSK të paktën 20 vjet, dhe kanë arritur moshën 55 vjeçare, ose nëse kanë nevojë që të përfundojnë shërbimin e tyre për shkak të aftësisë së kufizuar që rezulton nga plagët e marra gjatë shërbimit.⁴²

Shuma e pensionit është vendosur si një përqindje e pagës bruto të pjesëtarit dhe kohës në shërbim, dhe në bazë të rangut të tyre. Pensioni bazë është 40% i pagës së tyre bruto në momentin e daljes në pension. Për çdo vit shërbimi, shumën rritet me 2%, por nuk mund të kalojë 60% të pagës së tyre.⁴³

Përfituesit e marrin këtë pension pavarësisht nëse ata vazhdojnë të punojnë në sektorë të tjerë, për aq sa ata shërbejnë në FSK.⁴⁴ Megjithatë, ata mund të zgjedhin nëse duan të marrin këtë pension ose pensionin nga një skemë që vlen për ta.⁴⁵ Anëtarët e familjes (bashkëshortët, fëmijët dhe prindërit) e pjesëtarëve të FSK-së kanë të drejtë të marrë këtë pension, nëse anëtari i FSK-së ka ndërruar jetë.

Përsëri, shumica e përfituesve të këtij pensioni janë burra shqiptarë, pasi ata e kanë përbërë shumicën e personave në FSK. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2015 është 800,000 €, 69% e të cilave i shpërndahet burrave shqiptarë, 17% grave shqiptare dhe 14% të burrave jo-shqiptarë. Asnjë femër jo-shqiptare nuk merr këtë pension, pasi ato nuk kanë shërbyer në FSK.

Tabela 18. Përfituesit e pensionit të FSK-së sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Përfituesit	Shq. burra	% Shq. Burra	Shpenzuar Shq. Burra	Shq. g.	% Shq. g.	Shpenzuar Shq. gra	Jo-shq. burra	% jo-shq. burra	Shpenzuar jo-shq. burra
2013	105	98	93%	209,257	5	5%	19,665	2	2%	5652
2014	105	98	93%	209,257	5	5%	19,665	2	2%	5662
2015	175	154	88%	550,161	13	7%	136,780	8	5%	113,059
2016	200	167	84%	705,161	21	11%	234,280	12	6%	170,559
2017	240	185	77%	838,361	37	15%	300,800	18	8%	237,159
2018	298	219	73%	841,497	53	18%	300,880	26	9%	234,023

³⁹ Po aty, Art. 4.

⁴⁰ RrGGK, *Buxheti drejt Mirëqenies Sociale*

⁴¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë, 2012, në: http://www.mksf-s.org/repository/docs/ON_PENSIONS_OF_MEMBERS_OF_THE_KOSOVO_SECURITY_FORCE.pdf

⁴² Po aty, Neni 6

⁴³ Po aty, Neni 7.

⁴⁴ RrGGK, *Buxheti drejt Mirëqenies Sociale*

⁴⁵ Po aty.

Buxheti për këtë pension pritet të mbetet i njëjtë në vitin 2016, dhe të rritet në vitet 2017 dhe 2018 (shih Tabelën 19). Në të njëjtën kohë, FSK-ja ka vlerësuar se numri i përfituesve të pensioneve do të rritet (shih Tabelën 18).

Tabela 19 tregon se FSK-ja vazhdimisht ka mbi-buxhetuar për transfertat e saj. Kjo tendencë u vërejt edhe vitin e kaluar.⁴⁶

Tabela 19. Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar i FSK-së sipas viteve

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	Ndryshimi në %
2013	631,200€	234,559€	37%
2014	537,200€	465,337€	79%
2015 (Shta.)	800,000€	376,083€	49%
2016	800,000€		
2017	1,110,000€		

Pensioni për personat e verbër

Pensioni për personat e verbër rregullohet me Ligjin Nr 04/L-092 për personat e verbër.⁴⁷ Ligji përcakton kriteret e pranueshmërisë dhe përshkruan përfitimet dhe të drejtat e personave të verbër. Kompensimi bazohet në pagën minimale në Kosovë, por nuk mund të jetë nën 100 €. ⁴⁸ Personat kualifikohen pas një vlerësimi të kryer nga një komision mjekësor-social nga MPMS-ja në Prishtinë apo rajonet tjera të Kosovës. ⁴⁹ Që nga prilli 2014, rritjet e pensioneve kanë bërë që çdo person i verbër të merr të paktën 125 € në muaj dhe secili prej përcjellësve të tyre të paktën 125 € në muaj. ⁵⁰

Në vitin 2014, subvencionet dhe transferet për këtë pension arritën në 1.800.000 € (shih Tabelën 20). Me rritjen e pensioneve, buxheti për këtë pension u rrit më shumë se dyfish në vitin 2015. Është planifikuar që të mbeten të njëjta gjatë vitit 2017.

Tabela 20. Buxheti i Pensionit të Përzier

Viti	Subvencionet dhe transferet
2014	1,800,000
2015	3,914,888
2016	3,914,888
2017	3,914,888

Sipas regjistrimit të vitit 2011, 9,435 njerëz në Kosovë janë ose të verbër ose me dëmtime të rënda të shikimit: 46% janë burra dhe 51% gra. Megjithatë, Tabela 21 tregon se në vitin 2014 vetëm rreth një e treta e këtyre njerëzve (3,144) kanë marrë pension për të verbër. Vetëm personat plotësisht të verbër e marrin këtë pension, kështu që jo të gjithë njerëzit regjistruar në regjistrim si të verbër ose me shikim të dëmtuar e kanë këtë të drejtë. Nga të gjithë përfituesit e pensionit, 58% ishin burra dhe 42% gra. Përderisa gratë përbënin 51% të të gjithë personave të verbër në Kosovë, ato marrin vetëm 42% të përfitimeve të pensionit. Kjo mund të sugjerojë se disa gra të verbra mund të mos jenë të informuara për të drejtën e tyre për këtë pension.

Për sa i përket përkatësisë etnike, derisa burrat shqiptarë përbënin 52-53% të përfituesve, ata morën 57% të fondeve. Gratë shqiptare morën 31% të fondeve, burrat jo-shqiptarë 8%, dhe gratë jo-shqiptare 4%.

Tabela 21. Përfituesit e pensionit për personat e verbër sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë

Viti	Përfituesit	Shq. B.	% Shq. B.	Shpenzuar Shq. B.	Shq. G.	% Shq. G.	Shpenzuar Shq. G.	Jo-shq. B.	% Jo-shq. B.	Shpenzu ar jo-shq. B.	Jo-shq. G.	% Jo-shq. G.	Shpenzu ar jo-shq. G.
2014	3,144	1,674	53%	3,092,252	1223	39%	1,713,778	158	5%	418,000	89	3%	216,550
2015	3,346	1,751	52%	2,806,974	1295	39%	1,988,456	192	6%	383,685	108	3%	320,884
2016	3,456	1,806	52%	2,837,038	1323	38%	2,003,487	206	6%	391,201	121	4%	328,401
2017	3,558	1,846	52%	2,868,201	1358	38%	2,019,069	218	6%	398,992	136	4%	336,191
2018	3,650	1,880	52%	2,889,100	1390	38%	2,036,909	232	6%	410,461	148	4%	345,572

⁴⁶ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 38.

⁴⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës Ligji Nr. 04/L-092 për personat e verbër, 2012, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20for%20blind%20%20persons.pdf>.

⁴⁸ Po aty, neni 7.

⁴⁹ Po aty, neni 17.

⁵⁰ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*.

Gjetjet kryesore

- Edhe pse të dhënat e regjistrimit sugjerojnë se ka më shumë gra të verbra sesa burra, më shumë burra e kanë marrë këtë pension. Gratë e verbra shqiptare në veçanti mund të mos jenë në dijeni për të drejtën e tyre për këtë pension. Burrat e verbër shqiptarë gjithashtu marrin më shumë fonde të pensioneve se sa gratë e verbra shqiptare, edhe pse arsyet janë të paqarta.

Rekomandimet

- Të bashkëpunohet me shoqatat për të verbër, veçanërisht shoqatat për të verbër të udhëhequra nga gratë për të informuar njerëzit për të drejtat e tyre në këtë pension, duke synuar veçanërisht gratë shqiptare.

Departamenti i Punës dhe Punësimit

Departamenti i Punës dhe Punësimit është përgjegjës për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe implementimin e politikave të punësimit dhe politikave të formimit profesional. Ai përbëhet nga divizionet e mëposhtme: Divizioni i Politikave të Punësimit, Divizioni për Aftësi Profesionale, dhe Divizioni për Koordinimin dhe Monitorimin e Zyrave të Punësimit. Departamenti gjithashtu mbikëqyr rrjetin e shtatë qendrave rajonale të punësimit, 23 zyrat komunale të punësimit, tetë qendrat e trajnimit profesional, si dhe tri njësi mobile të trajnimit.⁵¹

Secila nga këto janë analizuar nga perspektiva e buxhetimit gjinor në pjesët vijuese. Tabela 22 tregon se në vitin 2014, Departamenti i Punës dhe Punësimit është mbi-buxhetuar me 20%.

Tabela 22. Departamenti i Punës dhe Punësimit Buxheti i Planifikuar dhe i Shpenzuar, 2014-2018			
Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	% ndryshimi
2014	4,036,517€	3,658,989€	2014
2015	4,378,388€	2,722,097€	2015
(Shtat.)			(Shtat.)
2016	6,469,562€		2016
2017	7,448,262€		2017
2018	7,448,262€		2018

Personat e regjistruar në Zyrat e Punësimit

Kosova ka një nga normat më të larta të papunësisë në rajon. Më tej, Anketa e Fuqisë Punëtore e vitit 2014 tregon se që nga viti 2013, papunësia dhe normat e pasivitetit janë rritur edhe për burra edhe për gra. Tabela 23 tregon se gratë, gratë e reja në veçanti, janë më të prekura nga papunësia dhe pjesëmarrja e ulët e forcës punëtore sesa burrat. Afër 80% e grave në krahasim me 38.2% të burrave janë ekonomikisht joaktive. Shkalla e punësimit është vetëm 12.5% te gratë dhe 41.3%, te burrat. Shkalla e papunësisë është 41.6% për gratë dhe 33.1% për burrat. Më tej, 56.2% të burrave të rinj janë të papunë në krahasim me 71.7% të grave të reja.

Tabela 24 paraqet përqindjet e grave dhe burrave të regjistruar në zyrat e punësimit në vitin 2013 dhe 2014, personat e sapo-regjistruar në 2013-2015, dhe parashikimet për 2016-2018. Në vitin 2014, 274,490 njerëz ishin regjistruar si të papunë, 46.6% gra dhe 53.3% burra. Pjesa totale e burrave dhe grave të regjistruar në vitin 2013 dhe 2014 ka mbetur e ngjashme me atë në vitet e mëparshme.

Tabela 23. Pjesëmarrja e fuqisë punëtore, pasiviteti dhe papunësia te gratë dhe burrat në vitin 2014			
	Burra	Gra	Total
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	61.8%	21.4%	41.6%
Shkalla e pasivitetit	38.2%	78.6%	58.4%
Shkalla e punësimit	41.3%	12.5%	26.9%
Shkalla e papunësisë	33.1%	41.6%	35.3%
Papunësia e të rinjve (mosha 15-24)	56.2%	71.7%	61.0%

⁵¹ RrGGK Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale.

Tabela 24. Punëkërkesit e sapo regjistruar në Zyrat e Punësimit sipas gjinisë								
Viti	Gjithsej të regj.	Gjithsej gra	Gjithsej burra	Totali i të regj. rishhtas	G. të regj. rishtas	3. të regj. rishtas	% e G. të regj. rishtas	% e B. të regj. rishtas
2013	268,104	124,369 (46.4%)	143,735 (53.6%)	13,128	4,336	8,792	33%	67%
2014	274,490	127,921 (46.6%)	146,566 (53.4%)	32,927	10,084	22,843	31%	69%
2015				17,390	5,084	12,306	29%	71%
2016				33,180	10,102	23,078	30%	70%
2017				33,180	10,102	23,078	30%	70%
2018				33,180	10,102	23,078	30%	70%

Përqindja e burrave të sapo regjistruar (67% -71%) dhe grave (29% -33%), gjithashtu ka mbetur mjaft e qëndrueshme në 2013-2015.⁵² Duke pasur parasysh se një përqindje shumë më e lartë e grave (41.6%) sesa burra (33.1%), janë të papunë, veçanërisht gratë e reja (71.7%), do të ishte e udhës që të sugjerohet se zyrat e punësimit duhet të kërkojnë aktivisht për të synuar dhe përkrahur grupet me normat më të larta të papunësisë, përkatësisht: gra të reja, burra të rinj, dhe gra. Departamenti nuk ka planifikuar që të rrisë përqindjen e grave të regjistruara në zyrat e punësimit. Personat e regjistruar në zyrat e punësimit parashikohet të mbesin 70% burra dhe 30% gra nga viti 2016 deri në 2018.

Në vitin 2013, burrat shqiptarë përbënin 58% të personave të sapo regjistruar në zyrat e punësimit, dhe gratë shqiptare përbënin 28% (shih Tabelën 24). Burrat serbë përbënin 3%, gratë serbe 1%, burrat romë, ashkali dhe egjiptian (RAE)⁵³ 3%, RAE gratë

Tabela 25. Personat e sapo regjistruar në Zyrat e Punësimit sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë

Viti	Sapo regjistruar	% Shq. burra	% Shq. gra	% Serb burra	% S. gra	% RAE b.	RAE g.	Burra tjerë	Gra tjera
2013	13,128	58%	28%	3%	1%	3%	1%	3%	2%
2014	32,927	61%	27%	3%	1%	2%	1%	3%	2%
2015	17,390	64%	26%	3%	1%	1%	1%	3%	2%
2016	33,180	61%	26%	3%	1%	3%	1%	3%	1%
2017	33,180	61%	26%	3%	1%	3%	1%	3%	1%
2018	33,180	61%	26%	3%	1%	3%	1%	3%	1%

1%, burra të përkatësive tjera etnike 3%, dhe gra nga kombësitë e tjera 2%. Që nga atëherë, përqindja e personave të regjistruar në zyrat e punësimit që janë burra shqiptarë duket se është rritur, ndërsa përqindja e grave shqiptare ka rënë. Përqindja e grave dhe burrave serbë, si dhe përqindja e grave RAE ka mbetur e njëjtë, por përqindja e burrave RAE ka rënë 1% në vit. Duke shikuar përpara, Departamenti ka planifikuar që përqindjet e grave dhe burrave nga grupet etnike të ndryshme të mbeten mjaft të qëndrueshme. Anketa e Fuqisë Punëtore për vitin 2014 nuk përfshin të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, gjë që e bën të vështirë për të krahasuar nëse shërbimet e ofruara nga zyrat e punësimit patën synim një pjesë të ngjashme të popullsisë si ata të papunë, sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë.

Gjetjet kryesore

- Burrat shqiptarë kanë tendencë të përfitojnë më shumë nga shërbimet e punësimit se sa gratë shqiptare, edhe pse gratë shqiptare kanë tendencë të jenë të papuna në shkallë të lartë, veçanërisht gratë e reja.

⁵² Duke pasur parasysh natyrën e këtyre shërbimeve, nuk është e mundur që të llogariten se sa është shpenzuar për gra dhe burra, përkatësisht, sipas grupit etnik.

⁵³ Ndërsa RrGGK njih dallimin në mes grupeve etnike të rmëve, ashkalive dhe egjiptianëve, për shkak të mënyrës në të cilën të dhënat mbledhen dhe raportohen në Kosovë, RrGGK nuk kishte zgjidhje tjetër përpos që të përdorë një akronim për paraqitjen e të dhënave për të tri grupet e kombinuara në një pasi kjo ishte e vetmja mënyrë që këto të dhëna të ishin në dispozicion. Kjo nuk do të thotë se RrGGK i konsideron romët, ashkalitë dhe egjiptianët si një grup të vetëm etnik, por më tepër si tri grupe të ndryshme etnike me akronimin "RAE".

- Në mesin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, burrat gjithashtu priren të jenë të regjistruar në shërbimet e punësimit më shumë se gratë e të njëjtit grup etnik.
- Anketa e Fuqisë Punëtore për vitin 2014 nuk përfshinte të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Rekomandimet

- Ndërmarrja e përpjekjeve aktive në terren në bashkëpunim me organizatat e grave dhe me medie që kërkojnë për të rritur numrin e grave shqiptare, rome, ashkali, dhe egjiptiane të regjistruara në zyrat e punësimit, duke rritur përqindjen e përfituesve që janë gra.
- Adresimi i normave të larta të papunësisë të grave në Kosovë, si prioritet i qeverisë,⁵⁴ kërkon veprime afirmative nga Departamenti dhe zyrat e punësimit për të inkurajuar më shumë gra që të regjistrohen për ndihmë, veçanërisht gratë shqiptare dhe ato rome, ashkali dhe egjiptiane. Veprimet e tilla afirmative ndaj përmirësimit të barazisë gjinore në Kosovë janë të parapara me Ligjin për Barazi Gjinore.⁵⁵
- Kërkimi i të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, në mënyrë që ky informacion të mund të përdoret për analizë gjinore.

Personat e punësuar përmes Zyrave të Punësimit

Nga personat e lartpërmendur të regjistruar në zyrat e punësimit, në vitin 2014 këto zyra gjetën punë për 20% të njerëzve. Vazhdimisht janë punësuar më shumë burra sesa gra (shih Tabelën 26). Gratë përbënin më pak se një të katërtën e personave të punësuar nga zyrat e punësimit. Përqindja e grave të punësuar nuk është as përfaqësuese e popullsisë së grave të regjistruara në zyrat e punësimit, e as e grupit më të madh të synuar të grave të papuna në Kosovë.

Tabela 26. Personat e punësuar nga Zyrat e Punësimit sipas gjinisë

Viti	Gjithsej të punësuar	Gra të punësuar	Burra të punësuar	% Gra të punësuar	% Burra të punësuar
2013	7,281	1,590	5,691	22%	78%
2014	6,685	1,376	5,309	21%	79%
2015	6,843	1,738	5,105	25%	75%
2016	6,850	1,650	5,200	24%	76%
2017	7,160	1,905	5,255	27%	73%
2018	7,160	1,905	5,255	27%	73%

Në mënyrë të ngjashme, sa i përket përkatësisë etnike, burrat shqiptarë përbërë përqindjen më të madhe të personave të punësuar nga zyrat e punësimit në vitin 2013 (65%) dhe në vitin 2014 (60%). Përderisa kjo nuk është shumë e ndryshme nga përqindja e shqiptarëve të regjistruar në zyrat e punësimit, burrat shqiptarë janë të mbi-përfaqësuar në krahasim me përqindjen e grave shqiptare që janë të papuna në popullsinë (edhe pse jo të regjistruara). Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk ishin në dispozicion për grupet e tjera etnike. Megjithatë, serbët, RAE dhe grupet e tjera etnike duket se kanë qenë pak të mbi-përfaqësuar në aspektin e sigurimit të punësimit në krahasim me përqindjen e personave të papunë të regjistruar të këtyre përkatësive etnike (shih Tabelën 27).

⁵⁴ Qeveria është zotuar për zbutjen e papunësisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore. Në programin e saj aktual, Qeveria e Republikës së Kosovës angazhohet për zbutjen e varfërisë dhe papunësisë (shih Qeveria e Republikës së Kosovës, *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015 - 2018*, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Government_Programme_2015-2018_eng_10_mars.pdf). Përveç kësaj, Zyra e Kryeministrit të Kosovës ka identifikuar papunësinë dhe krijimi i mundësive të punësimit si një sfidë kyçe me të cilën ballafaqohet Kosova (shih: Zyra e Kryeministrit të Kosovës, *Deklaratë e Prioriteteve Afatmesme të Politikave 2014-2016*, 2013, f. 13, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Declaration_of_Medium-Term_Policy_Priorities.pdf).

⁵⁵ Ligji Nr. 05/020 për Barazi Gjinore, neni 6.

Tabela 27. Personat e punësuar nga Zyrat e Punësimit sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë											
Viti	Gjithsej të punësuar	Burra shqip.	Burra shqip.	Gra shqip.	Gra shqip.	Serbë	Serbë %	RAE	RAE %	Të tjerë	Të tjerë %
2013	7,281	4,729	65%	1,590	22%	233	3%	248	3%	481	7%
2014	6,685	4,025	60%	1,376	21%	290	4%	352	5%	642	10%
2015	6,843	2,417	35%	815	12%						
2016	6,850	4,600	67%	1,550	23%						
2017	7,160	4,650	65%	1,800	25%						
2018	7,160	4,650	65%	1,800	25%						

Tabela 28 tregon numrin dhe përqindjen e burrave të papunë dhe grave të regjistruara dhe të punësuar, përkatësisht, në zyrat e punësimit në vitin 2014 sipas moshës. Gratë e të gjitha moshave kanë më pak gjasa sesa burrat që të regjistrohen si punëkërkuese në zyrat e punësimit, edhe pse gratë përbëjnë shumicën e personave të papunë në Kosovë. Përqindja e ulët e grave të reja të regjistruara është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë së tyre. Të rinjtë duket se kërkojnë ndihmë për punësim me shkallë shumë më të lartë se sa gratë e reja.

Gratë nga të gjitha grupmoshat kishin më pak gjasa për t'u punësuar përmes zyrave të punësimit sesa burrat. Gratë e moshës 40 vjeçare e sipër duket se përballen me vështirësi të veçanta për sigurimin e punësimit në krahasim me burrat e së njëjtës kategori të moshës.

Tabela 28. Personat e regjistruar dhe personat e punësuar sipas moshës dhe gjinisë në vitin 2014									
Grupmosha	Burrat e regjis.	Gratë e regjis.	Gjithsej të regjis.	Burrat e regjis. %	Gratë e regjis.%	Burrat e punës.	Gratë e punës.	Burrat e punës. %	Gratë e punës. %
15 – 24	7,753	3,618	11,371	68%	32%	1,550	433	78%	22%
25 – 39	9,280	4,071	13,351	70%	30%	2,645	761	78%	22%
40 – 54	4,522	1,855	6,377	71%	29%	909	171	84%	16%
55 +	1,288	540	1,828	70%	30%	205	11	95%	5%

Tabela 29 ilustron se grupmosha më e punësuar nga zyrat e punësimit në vitin 2014 kanë qenë burrat e moshës 25-39, të cilët përbënin 40% të të gjithë personave të punësuar. Grupi tjetër më i shpeshti i punësuar kanë qenë burrat e moshës 15-24 vjeç (23% e të punësuarve), të pasuar nga burrat e moshës 40-54 (14%) dhe grave të moshës 25-39 (11%). Kur krahasohen me përqindjen e të papunëve të regjistruar në zyrat e punësimit, burrat e moshës 25-39 janë dukshëm të mbi-përfaqësuar në mesin e personave për të cilët është siguruar punësimi. Gratë e reja të moshës 15-24 janë veçanërisht të nën-përfaqësuar në mesin e personave të punësuar.

Tabela 29. Personat e regjistruar dhe të punësuar në vitin 2014 sipas grupmoshës dhe gjinisë							
Grupmosha	Gjithsej të regjis.	% e të gjithë burrave të regjis.	% e të gjitha grave të regjis.	Gjithsej të punësuar	% e moshës së regjistruar që ishin punësuar	Burrat si % e të gjithë të punësuarve	Gratë si % e të gjithë të punësuarve
15 – 24	11,371	24%	11%	1,983	17%	23%	6%
25 – 39	13,351	28%	12%	3,406	26%	40%	11%
40 – 54	6,377	14%	6%	1,080	17%	14%	3%
55 +	1,828	4%	2%	216	12%	3%	0%
Total	32,927	69%	31%	6,685	20%	79%	21%

Të dhënat nuk janë mbledhur në lidhje me numrin dhe përqindjen e grave dhe burrave të regjistruara, të zonave rurale dhe urbane, dhe të punësuar(a) nga zyrat e punësimit. Megjithatë, kjo mund të ndihmojë në identifikimin e mangësive në shërbimet e punësimit sipas zonës gjeografike, apo zonat të cilat punësojnë më shumë ose më pak gra apo burra. Kjo mund të japë mësim të rëndësishme për të dhënë informata për ofrimin e shërbimeve në të ardhmen.

Gjetjet kryesore

- Zyrat e punësimit kanë punësuar vazhdimisht pothuaj tri herë më shumë burra sesa gra. Burrat shqiptarë punësohen me shkallë më të lartë sesa gratë shqiptare në krahasim me popullatën e personave të papunë në Kosovë. Gratë nga të gjitha grupmoshat kanë më pak gjasë të regjistrohen në Zyrat e Punësimit, edhe pse ato kanë shkallë më të lartë të papunësisë sesa burrat.
- Në vitin 2014, vetëm 6% e personave të punësuar me ndihmën e zyrave të punësimit ishin gra të reja të moshës 15-24 dhe vetëm 3% ishin gra të moshave 40-54. Burrat e rinj të moshës 15-24 përbënin 23% të personave të punësuar. Burrat e moshës 25-39 ishin në mënyrë të konsiderueshme të mbi-përfaqësuar në mesin e personave të punësuar.
- Nuk janë mbledhur të dhëna në lidhje me numrin dhe përqindjen e grave dhe burrave ruralë dhe urbanë të regjistruar dhe të punësuar nga zyrat e punësimit.

Rekomandimet

- Personeli i zyrës së punësimit duhet të trajnohet dhe pastaj të inkurajohet të përdorë veprime afirmative për të rritur përqindjen e grave, veçanërisht grave të reja, të cilave u sigurojnë punësim, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Kjo mund të arrihet duke vendosur një kuotë të përqindjes së vendeve të punës që zyrtarët duhet të gjejnë për gratë dhe burrat e moshave të ndryshme. Raporti gjinor që synohet për personat e punësuar në çdo grupmoshë mund të përmirësohet hap pas hapi çdo vit derisa të arrihet barazia.
- Duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë në mesin e grave të reja (71.7%) dhe të burrave të rinj (56.2%), zyrat e punësimit duhet të instalojnë veprime afirmative që do të inkurajojnë më shumë të rinj që të regjistroheni me zyrat e papunësisë, si dhe të caktojnë prioritet identifikimin e mundësive të punësimit për personat e këtyre grupmoshave.
- Të bashkëpunohet me OShC-të, veçanërisht OShC-të e udhëhequra nga gratë, për të inkurajuar më shumë gra që të regjistrohen në zyrat e punësimit. Përpjekjet për regjistrim duhet të synojnë në veçanti gratë e reja (15-24).
- Të fillojnë me mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin dhe përqindjen e grave dhe burrave që janë banorë të zonave rurale dhe urbane, të regjistruar(a) dhe të punësuar(a) nga zyrat e punësimit.

Përfituesit e Programeve Aktive të Tregut të Punës

Në bashkëpunim të ngushtë me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me mbështetje nga Qeveria e Finlandës, MPMS-ja ka pasur një Program Aktiv të Tregut të Punës (PATP) që nga viti 2005. Një prej objektivave kryesore për të rinjtë e cënueshëm, veçanërisht gratë, është që të marrin shërbime të integruara të punës. Faza e dytë e PATP-së nga viti 2015 deri 2017 përfshin kontributin e akterëve ndërkombëtarë në buxhetin e programit, duke përfshirë financimin e përbashkët nga UNDP-ja (187,500 €), MPMS-ja (120,000 €), dhe Qeveria e Finlandës (1,200,000 €), që arrin në 1.507.500 € gjatë tri viteve.

Tabela 30 tregon se në vitin 2015 burrat dhe gratë, përfituesit e PATP-së kanë përfituar në mënyrë të barabartë nga trajnimi në vendin e punës. Pak më shumë burra (53%) sesa gra (47%) kanë përfituar nga programet e subvencionimit të programeve të vetë-punësimit. Më tej, tabela tregon që burrat janë të prirë që të marrin një përqindje pak më të lartë të fondeve se sa gratë, madje edhe kur krahasohet me përqindjen e burrave që ishin përfitues. Me fjalë të tjera, burrat përfituan pak më shumë fonde sesa gratë në të tri programet.

Tabela 30. Përfituesit e PATP-së në vitin 2015 (që nga tetori 2015)

Programi	Gjithsej përfitues	Gjithsej shpenzime	# g.	% g.	€ për g.	% e € për g.	# b.	% b.	€ për b.	% e € për b.
Trajnim në vendin e punës	287	43,050€	143	50%	21,450€	49%	144	50%	21,600€	51%
Subvencionimi i pagës	354	477,900€	165	47%	222,750€	47%	189	53%	255,150€	53%
Vetë-punësimi	43	225,800€	20	47%	100,300€	44%	23	53%	125,500€	55%

Gjetjet kryesore

- Ndonëse gratë dhe burrat kanë përfutur pothuajse në mënyrë të barabartë nga PATP-ja në vitin 2015, burrat kanë marrë një përqindje pak më të lartë të fondeve të shpërndara. Burrat gjithashtu kanë përfutur pak më shumë nga subvencionimi i pagave dhe programet e vetë-punësimit sesa gratë.

Rekomandimet

- Me qëllim zbutjen e papunësisë në Kosovë, si prioritet i qeverisë, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e pabarabartë të grave në tregun e punës dhe nevojën më të madhe të grave si një grup të synuar, mbështetësit e PATP-së dhe zbatuesit mund të bëjnë veprime shtesë afirmative që të sigurojnë që më shumë gra se sa burra të përfitojnë nga këto programe. Veprime të tilla afirmative duhet të zbatohen deri sa pjesëmarrja e grave dhe burrave në tregun e punës të arrijë një nivel të barabartë, siç parashihet me Ligjin për Barazi Gjinore.

Divizioni për Aftësim Profesional

Tabela 31 tregon se më shumë burra se gra kanë qenë të prirë për të përfutur nga qendrat e aftësimi profesional gjatë viteve 2013-2015 (që nga shtatori). Megjithatë, Divizioni në mënyrë të qartë ka rritur përqindjen e grave përfutuese në vitin 2015 (deri më sot), në krahasim me vitin 2014. Ky Divizion vetëm ka ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë, por jo sipas moshës, përkatësisë etnike, apo vendndodhjes gjeografike. Më tej, edhe pse janë vënë në dispozicion të dhënat se kush regjistrohet dhe kush i përfundoi programet e trajnimit në vitin 2014, këto të dhëna nuk janë siguruar në vitin 2015. Kjo ka ndodhur për shkak se të dhënat për braktisjet nuk janë integruar ende në Sistemin e Informatave për Menaxhimin e Punësimit (SIMP). Të dhënat për vitin 2013 tregojnë se më shumë gra se sa burra janë të prira për braktisje. RrGGK-ja më parë kishte rekomanduar që qendrat e aftësimi profesional të shqyrtojnë arsyet se pse ka braktisje në mesin e grave dhe burrave, duke intervistuar persona që janë larguar nga këto trajnime, lidhur me arsyet e tyre; kjo mund t'u mundësojë qendrave për identifikimin e zgjidhjeve për mbështetjen e njerëzve në përfundimin e trajnimit të tyre (dhe në këtë mënyrë duke e bërë efikas përdorimin e investimit tashmë të bërë nga qendra për këta persona).

Kjo, si dhe informatat në lidhje me atë se kush ishte punësuar pas trajnimit, janë të rëndësishme për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e programeve të trajnimit. Duke pasur parasysh natyrën e veçantë të aftësimi profesional dhe llojet e ndryshme të trajnimeve të ofruara, është vështirë të vlerësohet shuma e shpenzuar për gratë dhe burrat.

Tabela 31. Personat e trajnuar nga Qendrat për Aftësim Profesional dhe braktisjet e trajnimit sipas gjinisë									
Viti	Gjithsej të trajnuar	Burra	Gra	% Burra	% Gra	Gjithsej braktisje	Gjithsej # braktisje	% braktisjet gratë	% braktisjet Burra
2013	3,350	1,814	1,536	54%	46%	11%	358	15%	8%
2014	3,419	2,254	1,165	66%	34%				
2015	2,592	1,360	1,232	52%	48%				

Gjetjet kryesore

- Më shumë burra sesa gra kanë përfutur nga Qendrat për Trajnim Profesional, edhe pse është bërë progres në drejtim të rritjes së përqindjes së përfutueseve gra në vitin 2015.

Rekomandimet

- Të vazhdohet me zbatimin e veprimeve afirmative për të siguruar që gratë të regjistrohen dhe të përfundojnë aftësimin profesional së paku në përqindje të njëjtë me burra.

Pushimi i lehonisë

Departamenti i Punës dhe Punësimit monitoron, administron, dhe buxheton zbatimin e dispozitave të pushimit të lehonisë, në pajtim me Ligjin e Punës. Ligji aktual i Punës është duke u ndryshuar. Megjithatë, për momentin qeveria nuk kontribuon në kompensimin e pushimit të lehonisë gjatë gjashtë muajve të parë të tij. Gjatë kësaj periudhe, punëdhënësi mbulon 70% të pagës bazë të punonjësit.⁵⁷ Në tre muajt që pasojnë, qeveria mbulon 50% të pagës mesatare në Kosovë.⁵⁸ Tabela 32 ilustron pagën mesatare në Kosovë që nga viti 2011, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Deri në vitin 2015, “paga mesatare”, e përdorur nga MPMS-ja për pagesën e përfitimeve të pushimit të lehonisë ka qenë dukshëm më e ulët sesa paga mesatare aktuale. Megjithatë, MPMS-ja planifikuar rritjen e “pagës mesatare” të saj në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2015.

Viti	Shfytëzuar nga MPMS-ja	Publikuar nga ASK-ja
2011	292€	368€
2012	292€	372€
2013	292€	374€
2014	292€	364€
2015	374€	
(plan)		

Siç ilustrohet në Tabelat 33 dhe 34, numri i grave përfituese të këtij përfitimi është rritur gradualisht pothuajse çdo vit, siç është rritur edhe buxheti. Ndërkohë që shuma e saktë që është marrë mund të ndryshojë në varësi të kohëzgjatjes së pushimit të çdo gruaje, Tabela 34 tregon se ka të ngjarë që në vitin 2011, nëpunëset civile kanë përfituar më shumë (49%) se sa gratë që kanë punuar në sektorin publik (34%) ose sektorin privat (17%). Megjithatë, në vitin 2012-2015, një përqindje më e lartë e përfituesve ishin nga sektorët publik ose privat. Lidhur me moshën, përkatësinë etnike, vendndodhjen gjeografike, apo kohëzgjatjen e pushimit, nuk kishte asnjë informatë të disponueshme.

Viti	Gra	Buxheti i shpenzuar në €
2006	540	113,904
2007	889	208,908
2008	874	214,060
2009	920	236,628
2010	971	240,702

Viti	Shërbyesit civilë	%	Sektori publik	%	Sektori privat	%	Gjithsej	Buxheti i shpenzuar në €
2011	364	49%	256	34%	128	17%	748	256,833
2012	203	18%	560	50%	363	32%	1126	506,319
2013	238	19%	570	45%	462	36%	1270	523,212
2014	204	15%	531	39%	624	46%	1359	592,711
2015	170	14%	444	36%	609	50%	1223	814,091

Papunësia dhe punët e kujdesit

Në vitin 2011, të paktën 268.245 gra (98.1%) dhe 5,240 burra (1.9%) nuk kanë qenë ekonomikisht aktiv në javën para regjistrimit të popullsisë *për shkak* se ata kujdeseshin për shtëpinë apo familjen e tyre. Kjo ishte arsyeja kryesore pse gratë ishin ekonomikisht më së shumti jo-aktive (55.8%). Një anketë e ekonomive familjare e vitit 2015 nga RrGGK-ja gjithashtu sugjeroi se përgjegjësitë e kujdesit në shtëpi i ndalojnë gratë të hyjnë në tregun e punës.⁵⁹ Çdo politikë efektive për të ulur papunësinë, që është më e përhapur në mesin e grave sesa burrave, duhet të marrë parasysh rolin e pabarabartë që kanë gratë në kryerjen e punëve të kujdesit dhe të ofrojë mundësi për përkujdesje për anëtarët e familjes së grave, duke bërë të mundur që ato të punojnë. RrGGK-ja ka vlerësuar se investimi në objektet e kujdesit në pajtim me Objektivat e

⁵⁶ ASK, Komunikatë për media, “Kosova në shifra 2012,” 12 qershor 2013, marrë nga: <http://ask.rks-gov.net/zyra-e-shfytit/602-komunikate-per-media-kosova-ne-shifra-2012>.

⁵⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji i Punës Nr 03 / L-212, 2010, Neni 49 (3), marrë nga: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>.

⁵⁸ Po aty, Neni 49(4).

⁵⁹ RrGGK, Mjaft më me arsytetime: Një Analizë e qëndrimeve, Incidencës dhe Përgjigjeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, Prishti marrë nga: RrGGK, 2015.

Barcelonës⁶⁰ mund të krijojnë të paktën 8,019 vende të reja pune.⁶¹ Kjo mund të kontribuojë në rreth tre milionë euro të ardhura të tjera, ndërkohë që taksat vjetore do të arrinin së paku vlerën prej 233.513 €.⁶² Përveç kësaj, kjo do të mundësonte që më shumë gra që aktualisht janë ofruese të kujdesit, të punojnë pasi ato nuk do të kenë më përgjegjësi për kujdesje gjatë ditës.

Gjetjet kryesore

- Adresimi i shkallës së lartë të papunësisë të grave dhe pjesëmarrjes së ulët të tyre në fuqinë punëtore në tregun e punës kërkon vëmendje ndaj aktiviteteve të përkujdesjes dhe identifikim të mundësive alternative të kujdesit.

Rekomandim

- Të investohet në objektet e përballeshme të kujdesit (private, publike, apo partneritetet publiko-private) si veprim afirmativ i paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore, që do të krijojë vende pune për gra dhe burra, si dhe do t'u mundësojë më shumë grave të punojnë duke ofruar shërbime të kujdesit.

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes (DPSF) zhvillon dhe zbaton politikat dhe legjislacionin në lidhje me mirëqenien sociale. Ky departament gjithashtu administron ndihmën dhe skema të tjera të përfitimit lidhur me politikat e familjes dhe shërbimet sociale, duke përfshirë ndihmën sociale.⁶³ DSPF-ja aktualisht përbëhet nga dy divizione: Divizionin për Ndihma Sociale dhe Divizioni për Shërbime Sociale.

Divizioni për Ndihma Sociale

Skema e Ndihmës Sociale në Kosovë (SNS) është krijuar në vitin 2003 me Ligjin Nr 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.⁶⁴ SNS-ja ofron ndihmë sociale për familjet në nevojë të cilat janë në pajtim me kriteret e pranueshmërisë. Ligji përcakton dy kategori të ndihmës sociale: Kategorinë 1 të SNS-së dhe Kategorinë 2 të SNS-së. Për t'u kualifikuar për Kategorinë 1 të SNS-së për ndihmë, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë persona të varen nga të tjerë,⁶⁵ dhe asnjë prej tyre nuk duhet të punojë.⁶⁶ Kategoria 2 e SNS-së është për të gjitha familjet, në të cilën një anëtar i familjes është në gjendje të punojë dhe ka të paktën një fëmijë që është nën moshën pesë vjeçare ose që është jetim nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare.⁶⁷ Më tej, në mënyrë që të kenë të drejtë, parashtruesit nuk mund të zotërojnë pronë më të madhe se pesë hektarë, bagëti, pajisje të përdorura për qëllime shtëpiake dhe komerciale, apo automjete. Anëtarët e familjes që marrin pension bazë apo pension të aftësisë së kufizuar mund të mos numërohen kur llogaritet ndihma sociale e familjes.⁶⁸

⁶⁰ Komisioni Evropian, *Objektivat e Barcelonës*, Belgjikë: Komisioni Evropian, 2013, marrë nga: http://eurogender.eige.europa.eu/sites/default/files/130531_barcelona_en.pdf.

⁶¹ Vini re se ky numër është llogaritur bazuar vetëm në objektet e kujdesit për fëmijët. Numri do të jetë dukshëm më i lartë kur merren parasysh përkujdesja për të moshuarit, për aftësinë e kufizuar, dhe forma të tjera të kujdesit.

⁶² RrGGK, *Ekonomia e Kujdesit dhe Pjesëmarrja e Fuqisë Punëtore të Grave*, e ardhshme.

⁶³ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 18

⁶⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, 2003, marrë nga: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_15_en.pdf.

⁶⁵ Sipas Ligjit nr. 2003/15, nenit 2.7, anëtarët e varur përfshij marrë nga: "Personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara, Personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar; Kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi përherë të kufizuara apo të personave në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeçe; Personat deri në moshën katërmëdhjetë (14) vjeç; Personat ndërmjet moshave pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm; dhe Prindërit vetushqyes me, së paku, një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç".

⁶⁶ Po aty, Neni 4(a).

⁶⁷ Po aty, Neni 4(b).

⁶⁸ Po aty, Neni 2.2.

Shuma e ndihmë sociale të marrë nga familjet ndryshon sipas madhësisë së familjes.⁷⁴ Siç ka argumentuar RrGGK-ja në hulumtimin e tij të mëparshëm, normat e ndihmës sociale historikisht nuk kanë përmbushur shpenzimet për nevojat themelore të identifikuar në indeksin e çmimeve të konsumit të shportës minimale të mallrave në vitin 2012. Kjo do të thotë se personat e varur nga ndihma sociale jetonin në varfëri në Kosovë.

Megjithatë, më 1 nëntor 2015, MPMS-ja dhe Ministria e Financave

paraqitën një vendim për të rritur ndihmën sociale me 25%. Duke filluar nga gushti i vitit 2016, ky vendim do të ndikojë në rreth 16,000 familje dhe 115,000 anëtarë të familjes. Vendimi do të rrisë ndihmën sociale mujore prej 76 €- 95 € për person.⁷⁵

Tabela 36 tregon se buxheti i planifikuar për vitin 2016, duke përfshirë rritjen, do të jetë 30.653.324 €. Buxheti pastaj planifikohet të ulet në 28.153.324 € në vitin 2017 dhe 2018 (duke mbetur i njëjtë në dy vitet). Rënia e buxhetit reflekton planet për punësimin e më shumë personave që aktualisht marrin ndihmë sociale. Përfaqësuesit e Ministrisë gjithashtu planifikojnë pastrimin e listave të përfituesve për të ulur numrin e përfituesve, siç pasqyrohet në Tabelat 37 dhe 38 më poshtë.

Tabela 35. Normat e Standardit Mujor⁶⁹

# të anëtarëve të familjes	Normat e Standardit Mujor 2003	Normat e Standardit Mujor nga janari 2009	Normat e Standardit Mujor nga qershori 2012	Indeksi i çmimeve të konsumit të shportës minimale të mallrave 2012 ⁷¹
1	35€	40€	40€	63.00€
2	50€	55€	55€	100.00€
3	55€	60€	60€	133.66€
4	60€	65€	65€	164.25€
5	65€	70€	70€	193.00€
6	70€	75€	75€	224.60€
7	75 ⁷² €	80€	80€	
8	75€	80€	85 ⁷³ €	

Tabela 36.

Shpenzimet e planifikuara të ndihmës sociale

Viti	Shpenzimet
2016	30,653,324€
2017	28,153,324€
2018	28,153,324€

Tabela 37. Totali i përfituesve të kategorisë 1 dhe 2 të SNS-së, të ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Gjithsej	B. shq.	G. shq.	B. ser.	G. ser.	B. RAE	G. RAE	Të tjerë b.	Tjera g.
2013	127,997	62,210 49%	42,752 33%	5,335 4%	3,354 3%	6,350 5%	4,263 3%	2,280 2%	1,453 1%
2014	124,720	60,153 48%	41,258 33%	5,570 5%	3,393 3%	6,350 5%	4,263 3%	2,280 2%	1,543 1%
2015	114,220	56,897 50%	38,654 34%	4,568 4%	3,125 3%	5,254 4%	3,568 3%	1,122 1%	1,032 1%
2016	104,720	53,897 51%	33,654 32%	3,668 4%	3,025 3%	5,054 5%	3,368 3%	1,022 1%	1,032 1%
2017	94,530	50,897 54%	30,654 32%	2,668 3%	2,025 2%	4,054 4%	2,368 3%	985 1%	879 1%
2018	86,809	45,897 53%	27,654 32%	2,668 3%	2,525 3%	4,054 4%	2,368 3%	858 1%	785 1%

⁶⁹ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 18

⁷⁰ UNDP, *Vlera e vërtetë e Ndhmës Sociale: Një vlerësim i Mjaftueshmërisë së Përfitimit të Ndhmës Sociale*, Prishtinë UNDP, 2014, marrë nga:

<http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Communications/Dokumenti%20The%20Real%20Value%20of%20Social%20Assistance%20ONLINE.pdf>.

⁷¹ Kjo bazohet në metodologjinë e analizës së *Bankës Botërore Varfëria dhe Pabarazia 2002-2003* analizave, e cila llogaritit koston e re të shportës minimale të konsumit të ushqimit dhe shumën mujore të ndihmës sociale duke përdorur të dhënat nga Anketa e Ekonomive Shtëpiake 2012. Metodologjia parasheh për ndryshime në përbërjen e shportës ushqimore minimale dhe çmimet që nga viti 2012.

⁷² Legjislacioni caktoi një kufi prej 75 € në muaj për familjet që kanë më shumë se shtatë (7) anëtarë. Në janar të vitit 2009, kufiri u ngrit në 80 € në muaj për familje të tilla.

⁷³ Amendamenti i vitit 2012 ka hequr kufirin prej 80 € për familjet me më shumë se shtatë (7) anëtarë; 5 € shtesë i shtohen në përfitim mujor për çdo anëtar shtesë.

⁷⁴ *Po aty*, Neni 2.2.

⁷⁵ Telegrafi, "Konfirmohet rritja e të ardhurave të asistencës sociale për 25 për qind," 2015, marrë nga:

<http://www.telegrafi.com/lajme/konfirmohet-rritja-e-te-ardhurave-te-asistences-sociale-per-25-per-qind-2-72772.html>.

Përderisa burrat përbëjnë shumicën e personave që fizikisht i marrin ndihmat sociale (60%) në emër të familjeve të tyre (shih Tabelën 37),⁷⁶ shumica e anëtarëve të familjes që varen nga ndihma sociale janë gra (60-65%). Përfituesit mund të paraqesin ankesa në qoftë se nuk e marrin pjesën e tyre të ndihmës sociale, dhe mund të kërkojnë që ndihma sociale e tyre të transferohet te një anëtar tjetër të familjes.⁷⁷ Megjithatë, sipas zyrtarëve të MPMS-së, transferimi ndodh rrallë dhe të dhënat e konsoliduara në lidhje me atë se sa shpesh ka ndodhur kjo nuk ishin në dispozicion.

Tabela 38. Tërheqësit dhe Përfituesit e Ndhmës Sociale

Viti	Tërheqëset gra	Tërheqësit burra	Gjithsej anëtarë të familjes	Anëtare të familjes gra	Anëtarë të familjes burra	Gjithsej buxheti
2013	51,822 (40%)	76,175 (60%)	127,997	73,954 (60%)	49,600 (40%)	27,200,000
2014	50,367 (40%)	74,353 (60%)	124,720	74,535 (60%)	50,367 (40%)	27,280,000
2015	46,379 (41%)	67,841 (59%)	114,220	69,781 (65%)	38,272 (35%)	26,138,685

Tabela 39 tregon përfituesit e dy kategorive të ndihmës sociale, të ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike. Burrat e të gjitha përkatësive etnike marrin ndihma sociale më shumë se gratë nga e njëjta përkatësi etnike. Nuk ka të dhëna në dispozicion për të vlerësuar përqindjen e grupeve të ndryshme etnike në nevojë për ndihmë sociale. Megjithatë, në aspektin e përbërjes etnike të popullsisë së Kosovës, si një tregues përfaqësues (proxy indicator), të gjithë personat e pakicave duket se janë pak më të mbi-përfaqësuar në mesin e përfituesve të SNS-së.

Tabela 39. Buxheti për kategoritë 1 dhe 2 të SNS-së, ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike të përfituesve

Viti	Buxheti total	Burrat shqiptarë	Gratë shqiptare	Burrat serbë	Gratë serbe	Burrat RAE	Gratë RAE	Burra të tjerë	Gratë tjera
2013	27,280,000	13,258,817 (49%)	9,111,734 (33%)	1,137,049 (4%)	714,838 (3%)	1,353,375 (5%)	908,573 (3%)	485,936 (2%)	485,936 (2%)
2014	26,721,564	12,887,927 (48%)	8,839,627 (33%)	1,193,386 (4%)	726,959 (3%)	1,360,503 (5%)	913,358 (3%)	488,496 (2%)	488,496 (2%)
2015	25,000,000	12,453,379 (50%)	8,460,427 (34%)	999,825 (4%)	683,987 (3%)	1,149,974 (5%)	780,949 (3%)	245,579 (1%)	245,579 (1%)
2016	30,653,324 ⁷⁸	14,410,963 (51%)	8,998,396 (32%)	980,749 (4%)	808,824 (3%)	1,351,337 (5%)	900,535 (3%)	273,262 (1%)	273,262 (1%)
2017	28,000,000	15,075,807 (54%)	9,079,784 (32%)	790,268 (3%)	599,810 (2%)	1,200,804 (4%)	701,407 (3%)	291,759 (1%)	291,759 (1%)
2018	28,000,000	14,803,949 (53%)	8,919,720 (32%)	860,556 (3%)	814,432 (3%)	1,307,606 (5%)	763,792 (3%)	276,746 (1%)	276,746 (1%)

Tabela 39 gjithashtu paraqet buxhetin total për kategorinë 1 dhe 2 të SNS-së për periudhën 2013-2015, si dhe parashikimet për 2016-2018.

⁷⁶ Ndoshta për shkak të faktit se burrat përbëjnë shumicën e krerëve të familjeve në Kosovë. Të dhënat e ASK tregojnë se 8.3% e familjeve drejtohen nga gratë. Të familjeve me kryefamiljare gra, 64.1% udhëhiqen nga gratë e veja (ASK, *Statistikat gjinore në Kosovë*, 2014, marrë nga: http://www.instat.gov.al/media/257404/gender_statistics_in_kosovo.pdf).

⁷⁷ RrGGK bisedë me zyrtarin e MPMS-së 2015.

⁷⁸ Në fillim buxheti është vlerësuar në shumën 28,000,000, megjithatë, që prej atëherë është rritur dhe ka mbërritur këtë shumë.

Kategoria I e SNS-së

Kategoria I e SNS-së u shpërndahet familjeve ku të gjithë anëtarët e familjes janë të varur,⁷⁹ dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.⁸⁰ Gjithsej, numri i përfituesve të Kategorisë I të SNS-së në vitin 2014 ishte 24.878, duke përfshirë 55% burra dhe 45% gra. Numri i përgjithshëm i përfituesve është rritur që nga viti 2013, por përqindja e burrave dhe grave ka mbetur e ngjashme. Ashtu si në vitet e mëparshme, shumica e anëtarëve të familjes në familjet që përfitojnë nga kategoria I e SNS-së janë gra (56% e përfituesve).

Tabela 40. Kategoria I e SNS-së e Përfituesve

Viti	# total i përfituesve	# total i burrave	# total i grave	# i anëtarëve të familjes	# total i anëtarëve burra të familjes	# total i anëtareve gra të familjes
2012	22,406	12,172 (54%)	10,234 (46%)	65,351	30,575 (47%)	34,776 (53%)
2013	20,963	11,320 (54%)	9,643 (46%)	60,508	28,245 (47%)	32,263 (53%)
2014	24,878	13,576 (55%)	11,302 (45%)	88,147	38,794 (44%)	49,353 (56%)

Megjithatë, Tabela 41 tregon se në vitin 2014, 55% e buxhetit është ndarë për përfitues burra, ndërsa 45% për përfituese gra. Shuma nuk është llogaritur në bazë të anëtarëve të familjes, por vetëm në bazë të përfituesve. Mund të vërehet se ndërkohë që burrat ende marrin shumicën e buxhetit (55%), përqindja e grave që e marrin atë është rritur dy për qind që nga viti 2013 (nga 43% në 45%). Të dhënat nga viti 2015 nuk janë përfshirë në Tabelën 40, sepse ende nuk janë finalizuar grupet e të dhënave.

Tabela 41. Përfituesit nga Kategoria I e SNS-së dhe Buxheti sipas gjinisë dhe vitit

Viti	# i përfituesve	# i burrave	# i grave	Buxheti total	Buxheti për përfitues burra	€ për kokë burra	Buxheti për përfitues gra	€ për kokë gra
2012	22,406	12,172 (54%)	10,234 (46%)	14,309,599€	8,125,598€ (57%)	55.6€	6,184,001€ (43%)	50.4€
2013	20,963	11,320 (54%)	9,643 (46%)	14,568,820€	8,272,422€ (57%)	60.9€	6,296,398€ (43%)	54.4€
2014	24,878	13,576 (55%)	11,302 (45%)	14,536,538€	7,932,633€ (55%)	48.6€	6,603,905€ (45%)	48.6€

Kategoria 2 e SNS-së

Kategoria 2 e SNS-së u shpërndahet të gjitha familjeve, në të cilën një anëtar i familjes është në gjendje për të punuar dhe ka të paktën një fëmijë nën moshën pesë ose një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare.⁸¹ Ngjashëm me vitin e kaluar,⁸² pabarazia gjinore në mesin e personave që përfitojnë nga Kategoria 2 e SNS-së është më e lartë sesa Kategoria I e SNS-së. Tabela 42 tregon se shumica e personave që mbledhin transferet e Kategorisë 2 të SNS-së vazhduan të jenë burra në vitin 2014 (85%). Megjithatë, pjesa më e madhe e anëtarëve të familjes të varur nga ky lloj i SNS-së janë gra (61%). Interesante, përqindja e grave që mbledhin këtë lloj të ndihmës u rrit prej 6% në vitin 2014, një

⁷⁹ Sipas Ligjit nr. 2003/15, nenit 2.7, anëtarët e varur përfshij marrë nga: "Personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara. Personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar; Kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi përherë të kufizuara apo të personave në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeçe; Personat deri në moshën katëmbëdhjetë (14) vjeç; Personat ndërmjet moshave pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm; dhe Prindërit vetushqyes me, së paku, një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç".

⁸⁰ Po aty, Neni 4(a).

⁸¹ Po aty, Neni 4(b).

⁸² RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 32.

rritje që nuk ka ndodhur në vitin 2012 apo 2013. Numri i përgjithshëm i përfituesve gjithashtu është rritur nga 16,776 në 19,349. Përqindja e burrave dhe grave anëtare të familjes të varur nga ndihma sociale në vitin 2012-2014 ka mbetur mjaft e qëndrueshme; në vitin 2014 ka pasur vetëm një për qind rritje të burra dhe një rënie prej një për qind të gratë.

Tabela 42. Shpërndarja e Përfituesve në Kategorisë 2 të SNS-së që përfitojnë nga transferet dhe shpërndarja e anëtarëve të familjeve sipas gjinisë						
Viti	# i përfituesve	Gjithsej # i burrave	Gjithsej # i grave	# i anëtarëve të familjes	# i anëtarëve burra të familjes	# i anëtarëve grave të familjes
2012	18,176	16,620 (91%)	1,556 (9%)	75,470	28,732 (38%)	46,738 (62%)
2013	16,776	15,317 (91%)	1,459 (9%)	69,209	26,546 (38%)	42,663 (62%)
2014	19,349	16,427 (85%)	2,922 (15%)	77,935	30,663 (39%)	47,272 (61%)

Tabela 42 tregon që burrat vazhdojnë të përfitojnë nga shumica e buxhetit total të ndarë për Kategorinë 2 të SNS-së. Kjo diferencë ka ekzistuar së paku që nga viti 2012. Hulumtimi paraprak i RrGGK-së ka vlerësuar se ky dallim mund të jetë pjesërisht për shkak të roleve të vazhdueshme tradicionale gjinore në Kosovë, për shkak të cilave burrat kanë tendencë të kenë përgjegjësi më të mëdha jashtë shtëpisë, duke përfshirë tërheqjen e ndihmës sociale, ndërsa gratë kanë përgjegjësi brenda në shtëpi, siç janë përkujdesja dhe punë të tjera në familje.⁸³ Një çështje tjetër mund të jetë fakti se në mënyrë që të kenë të drejtë në Kategorinë 2 të SNS-së, familjet duhet të kenë të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeçare, që ka gjasa të rritë më tej punët e kujdesit që bëjnë gratë brenda shtëpisë. Përfaqësuesit e Divizionit të SNS-së kanë thënë se ky dallim mund t'i atribuohet faktit se gratë nuk janë në gjendje që t'i lënë fëmijët e tyre nën moshën pesë vjeçare vetëm për të shkuar të rifitojnë ndihmën sociale.⁸⁴ Nëse gratë nuk janë përfituese të drejtpërdrejta, ato mund të mos kenë qasje në fondet e SNS-së kur financat shpërndahen brenda familjes. Duke pasur parasysh se gratë janë kujdestare parësore të fëmijëve dhe të moshuarve, SNS-ja mund të përdoret në mënyrë më efektive brenda familjes në qoftë se gratë marrin ndihmë sociale drejtpërdrejt. Megjithatë, ekziston nevoja për hulumtim të mëtejshëm lidhur me mënyrën se si shpenzohet ndihma sociale brenda familjeve.

Një ndryshim i vogël u vu re në vitin 2014, ku përqindja e buxhetit të marra nga gratë është rritur me 7%. Ndërsa në vitin 2013 gratë morën 8% të buxhetit, në vitin 2014, ato morën 15%. Kjo mund të sugjerojë se më shumë gra mund të përfitojnë nga Kategoria 2 e SNS-së në vitet e ardhshme.

Tabela 43. Përfituesit e Kategorisë 2 të Ndhmës Sociale sipas vitit, gjinisë dhe buxhetit								
Viti	Gjithsej përfitues	# i burrave (%)	# i grave (%)	Buxheti total	Buxheti total për burra	€ për kokë burrat	Buxheti për gra	€ për kokë gratë
2012	18,176	16,620 (91%)	1,556 (9%)	12,850,053€	11,782,088€ (92%)	59.1€	1,067,965€ (8%)	57.2€
2013	16,776	15,317 (91%)	1,459 (9%)	12,858,869€	11,803,649€ (92%)	64.2€	1,055,220€ (8%)	60.3€
2014	19,349	16,427 (85%)	2,922 (15%)	12,011,453€	10,197,537€ (85%)	51.7€	1,813,916€ (15%)	51.7€

Gjetjet kryesore

- Për të dyja kategoritë mund të vërehet se ndërsa burrat kanë më shumë gjasa për të tërhequr ndihmën sociale për familjet e tyre, gratë kanë më shumë gjasa të jenë në mesin e anëtarëve të familjes që janë të varur prej saj.

⁸³ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 32.

⁸⁴ Interviste e RrGGK, nëntor 2015.

- Totali i përfituesve sipas Kategorisë I të SNS-së është rritur prej vitit 2013 deri në vitin 2014, por pjesa e burrave dhe grave që përfitojnë sipas Kategorisë I të SNS-së ka mbetur e ngjashme. Ashtu si në vitet e mëparshme, shumica e anëtarëve të familjes në familje që përfitojnë nga Kategoria I e SNS-së janë gra (56% në 2014).
- Ndërsa burrat ende përfitojnë shumicën e buxhetit për SNS I (55% në vitin 2014), përqindja e grave që përfitojnë prej tij është rritur me dy për qind nga viti 2013 (nga 43% në 45%).
- Burrat kanë përbërë vazhdimisht shumicën e përfituesve të drejtpërdrejtë të Kategorisë 2 të SNS-së (91% në vitin 2012 dhe 2013 dhe 85% në vitin 2014). Megjithatë, përqindja e grave që janë përfituese të drejtpërdrejta është rritur për 7% nga 2013 në 2014 (nga 8% në 15%).

Rekomandimet

- Të kryhet një studim mbi arsyen pse më shumë burra përfitojnë SNS-së sesa gratë, si dhe mbi mënyrën se si shpërndahet ndihma sociale brenda familjes për të siguruar që anëtarët e familjes që nuk marrin ndihmë sociale të përfitojnë në mënyrë të barabartë. Nëse konstatohet se ekziston diskriminimin në praktikën e shpërndarjes, të identifikohen mënyrat për të siguruar që ndihma sociale të arrijë te të gjithë anëtarët e familjes.
- Të sigurohet që të gjithë personat që marrin SNS, duke përfshirë anëtarët e familjes, të kenë informacion se si ata mund të raportojnë keqpërdorimin ose të ndryshojnë përfituesit e ndihmës, për të siguruar që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre. Kjo mund të përfshijë, për shembull, një fushatë informimi duke synuar gratë në veçanti.
- Të vendosen indikatorë dhe të zhvillohen aktivitete specifike për të rritur përqindjen e grave që përfitojnë nga transferet e SNS-së.

Divizioni për Shërbime Sociale

Mes detyrave dhe përgjegjësi të tjera, Divizioni për Shërbime Sociale (DShS) zhvillon, propozon dhe monitoron zbatimin e shërbimeve sociale dhe të legjislacionit social, koordinon aktivitetet me aktorë të tjerë relevantë, bashkëpunon me OShC-të dhe zhvillon dhe propozon programe të trajnimit profesional për punonjësit e shërbimeve sociale.⁸⁵

Që nga vitit 2009, përgjegjësitë për ofrimin e shërbimeve sociale janë bartur nga niveli qendror në nivelin lokal.⁸⁶ Megjithatë, siç është vlerësuar në hulumtimin paraprak të RrGGK-së, ky proces i decentralizimit ka qenë i vështirë deri më tani.⁸⁷ Detyrat për të cilat çdo nivel është përgjegjës mbeten të paqarta, disa shërbime sociale mbeten të centralizuara,⁸⁸ dhe 40 Qendrat për Mirëqenie Sociale (QMS) rreth Kosovës mbeten të lidhura me nivelin qendror.⁸⁹ Mungesa e kapaciteteve në mesin e institucioneve të nivelit lokal dhe të zyrtarëve e ka penguar procesin e decentralizimit, sipas zyrtarëve të MPMS-së.⁹⁰ Shërbimet e ofruara përmes këtij Divizioni diskutohen në mënyrë individuale në seksionet në vijim.

⁸⁵ Faqja e internetit e MPMS-së, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/en-us/departments/departmentsocialpolicyandfamilies/socialservicesdivision.aspx>.

⁸⁶ Memorandumi i Mirëkuptimit (MM), i nënshkruar në shkurt të vitit 2009 në mes MPMS-së, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Financave, dhe komunave të Kosovës për kalimin e shërbimeve sociale në komuna.

⁸⁷ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*.

⁸⁸ Kjo përfshin shërbimet rezidenciale për të moshuarit, shërbime të bazuara në komunitet për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, shërbimet sociale të ofruara nga OShC-të, përfitimet e kujdesit birësues dhe përfitime për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

⁸⁹ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 18.

⁹⁰ Intervistë e RrGGK, maj 2015.

MPMS-ja kontraktonte OShC-të anembanë Kosovës për të ofruar shërbime të veçanta sociale. Tabela 45 ilustron shumën e transferuar në vitin 2015.

Tabela 45. Shumat e transferuara tek OShC-të nga MPMS-ja në vitin 2015		
Emri i OJQ-së ose Asociacionit	Total në €	Shërbime të ofruara për
Shpresë dhe shtëpi për fëmijët e Kosovës	14,900	Fëmijët
SOS Fshati i Fëmijëve të Kosovës	13,500	Fëmijët
Qendra për Kujdes Ditor-PEMA	13,000	Fëmijët
OJQ Handikos	13,500	Personat me aftësi të kufizuara
Associazione Amicide I Bambini	11,500	Fëmijët
OJQ "Humaniteti"	8,500	
Organizata multietnike për Persona me Aftësi të Kufizuara	4,500	Personat me aftësi të kufizuara
Shoqata e personave me aftësi të kufizuara "Dom Nade"	1,570	Personat me aftësi të kufizuara
Iniciativë të rinjve në <i>Kodrën e Trimave</i>	4,200	Të rinjtë
Zhvillimi aktiv i Shoqërisë	3,700	
Organizata e të Rinjve Aktiv	4,800	Të rinjtë
Qendra për të Rinj e Prishtinës	4,700	Të rinjtë
OJQ "Jeta Buron"	4,500	
Klubi "Dëshira"	4,800	
Codex	4,700	
Instituti Rinor i Kosovës	4,900	Të rinjtë
Qendra e OJQ-Gruas "Prehja"	3,900	Gratë
Instituti për Studime Sociale-Politike	4,500	
Festivali i filmit Hyjnesha në Fron	3,800	Gratë
Alternativa për Fuqizimin e Rinisë së Kosovës	3,300	Të rinjtë
Qendra Rinore Podujevë	4,300	Të rinjtë
Shoqata për të Verbër e Kosovës	4,900	Personat e verbër
Qendra për Mbështetje të Biznesit të Kosovës	4,950	
Shoqata "NënëTerezë"	4,900	
Letnica kuzhina kombëtare në Letuca	4,000	
Total	155,820	

Ndihma familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Kosova i nënshtrohet disa konventave ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës.⁹¹ Ekzistojnë edhe mekanizmat kombëtarë për garantimin e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë Ligjin nr. 03/L-022 për "ndihmë materiale për familjet e fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara",⁹² e cila garanton 100 € mbështetje në muaj për familjet e tyre.

Tabela 46 tregon numrin e familjeve që marrin ndihmë për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara. Më shumë familje me djem me aftësi të kufizuara e marrin këtë përfitim (53% -58%) sesa familjet me vajza (41% -48%). Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 3,376 persona të moshave 0-9 vuajnë nga një formë e aftësisë së kufizuar, prej të cilëve 40% janë vajza dhe 60% djem. Megjithatë, hulumtimi i mëparshëm i RrGGK-së ka treguar se këto të dhëna nuk mund të jenë të besueshme; dëshmitë nga përvoja tregojnë se familjet mund të kenë regjistruar më shumë djem se vajza me aftësi të kufizuara.⁹³

⁹¹ Kombet e Bashkuara, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, 1989, në <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>.

⁹² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershëm, Ligji Nr 03 / L-022, Prishtinë marrë nga: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/PrimarAnglisht/LAW%20ON%20MATERIAL%20SUPPORT%20FOR%20FAMILIES%20OF%20CHILDREN%20WITH%20PERMANENT%20DISABILITY.pdf>.

⁹³ Për më tepër shih RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 20.

Tabela 46. Numri i familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar sipas gjinisë së fëmijëve						
Viti	# total i përfutuesve	# total i vajzave	# total i djemve	Buxheti total	Buxheti për vajza	Buxheti për djem
2011	2,893	1,382 (48%)	1,511 (52%)	289,300	138,200 (48%)	151,100 (52%)
2012	2,946	1,396 (47%)	1,550 (53%)	294,600	139,600 (47%)	155,000 (53%)
2013	2,995	1,242 (41%)	1,753 (59%)	299,500	124,200 (41%)	175,300 (59%)
2014	2,903	1,213 (42%)	1,690 (58%)	290,300	121,300 (42%)	169,000 (58%)
2015	2,761	1,167 (42%)	1,594 (58%)	276,100	116,700 (42%)	159,400 (58%)

Gjetjet kryesore

- Më shumë marrin mbështetje mujore familjet me djem me aftësi të kufizuara sesa familjet me vajza me aftësi të kufizuara. Kështu, më shumë buxhet shkon për familje të djemve (58%) sesa për familje të vajzave (42%).

Rekomandimet

- Të bashkëpunohet me OShC-të që punojnë me persona me aftësi të kufizuara, veçanërisht me organizatat e grave, si dhe mediet për të siguruar që familjet me vajza me aftësi të kufizuara të sensibilizohen për të drejtat e fëmijëve të tyre, të cilat kanë të bëjnë me këto përfitime.
- Të rritet me një për qind në vit pjesa e familjeve me vajza që marrin këtë përfitim deri sa të arrijë 50%.

Strehimi familjar për fëmijët e braktisur

Sigurimi i strehimit familjar për fëmijët e braktisur rregullohet me Ligjin nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2006 për të rregulluar sigurimin e strehimit familjar për fëmijët e braktisur.⁹⁴ Të gjitha familjet që strehojnë fëmijë, i nënshtrohen trajnimit në mënyrë që të bëhen ofrues të strehimit familjar.⁹⁵ Strehimi familjar mund të ofrohet nga familjet strehuese biologjike dhe jo-biologjike. Në muajin e parë, familja jo-biologjike kujdestare merr një pagesë prej 225 € dhe në muajt e tjerë 150 €. Për rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, familja kujdestare merr 250 € në muaj.⁹⁶ Përveç strehimit në familje jo-biologjike, MPMS-ja ofron ndihmë për strehimin e fëmijëve brenda familjes, pa kujdes prindëror. Kompensimi është 75 € në muaj për fëmijët e strehuar.

Të dhënat e ofruara nga MPMS-ja në vitin 2014 tregojnë se buxheti i përgjithshëm i shpenzuar në strehim familjar ka qenë 144,400 € në vitin 2013, dhe se është rritur për 22% në vitin 2014.⁹⁷

Tabela 47. Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes së tyre biologjike ose në familjen e tyre të gjerë							
Viti	# total i rasteve të vjetra të strehimit familjar	# total i rasteve të reja	# total i fëmijëve me aftësi të kufizuara, që janë në strehim familjar	Buxheti total për strehim familjar jashtë familjes biologjike	# total i fëmijëve të strehuar në familjen e gjerë	Totali i buxhetit ⁹⁸	Buxheti total për strehim familjar
2011	48	51	7	120,635€	660	540,000€	660,635€
2012	54	33	7	116,830€	541	486,900€	603,730€
2013	59	47	7	144,400€	642	577,800€	722,200€

⁹⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Neni. 3.3i dhe 11; MPMS, Udhëzimi Administrativ Nr.05/2006 për Themelimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehim Familjar dhe Birësim, Prishti marrë nga: MPMS, 2006, marrë nga: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.05-2006%20On%20Establishment%20of%20the%20Panel%20for%20Placing%20Childre.pdf>, Art. 4.

⁹⁵ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 44.

⁹⁶ Në RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 44, RrGGK vuri në dukje se në janar të vitit 2012, kompensimi për një familje kujdestare është rritur nga 150 € deri në 250 €.

⁹⁷ MPMS, informatë e pranuar në maj 2014.

⁹⁸ Vlerësimet e RrGGK-në bazë të numrit të përgjithshëm të përfutuesve çdo vit dhe shuma mujore.

Divizioni për Fëmijët në Strehim Familjar gjithashtu monitoron dhe financon rastet e fëmijëve të braktisur dhe birësimin përmes SOS Kinderdorf (0-3 vjeç). Hulumtimi paraprak i RrGGK ka vlerësuar se numri i fëmijëve të cilët janë birësuar përmes SOS Kinderdorf është rritur në vitet 2011-2013.⁹⁹ Për fat të keq, të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me fëmijët e strehuar në SOS Kinderdorf nuk ishin në dispozicion në vitin 2014 dhe nuk janë në dispozicion as në vitin 2015. Të dhënat për vitin 2015 tregojnë se mund të mos ketë asnjë fëmijë të moshës 0-3 që jeton në SOS Kinderdorf. Megjithatë, edhe pse nuk ka asnjë fëmijë të moshës 0-3 vjeçare, financimi për fëmijë ka rënë ndjeshëm nga 36,9 € që ishte në vitin 2013, në 24,5 € në vitin 2015.

Tabela 48. Fëmijët në SOS Kinderdorf				
Viti	SOS (mosha 0-3)	SOS (mosha 4-18)	Buxheti për SOS	Mes. € për kokë për muaj
2011	32	47	44,893€	47.3€
2012	38	50	50,681€	47.9€
2013	40	52	40,764€	36.9€
2014	n/a	39	n/a	
2015	n/a	44	13,000€	24.5€

Rekomandimet

- Të mblidhen dhe të paraqiten të dhëna për gjininë e fëmijëve në strehim familjar dhe në OJQ-të tjera që ofrojnë shërbime sociale, siç është SOS Kinderdorf.
- Të sigurohen fonde të mjaftueshme për SOS Kinderdorf.

Strehimoret për mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare rregullon strehimin e personave që kanë pësuar dhunën në familje, trafikimin dhe abuzimin e fëmijëve.¹⁰⁰ Strehimoret janë paraparë si ofruesit e shërbimeve edhe me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.¹⁰¹ Përveç sigurimit të strehimit dhe sigurisë, strehimoret ofrojnë shërbime të ndryshme të tjera, siç janë ushqimi, kujdesi mjekësor, asistencë psikologjike, transporti, trajnimi profesional, artikuj të higjienës, dhe mbështetje për riintegrim dhe rehabilitim.¹⁰² Strehimoret mund të jetë jo-qeveritare, si dhe të drejtuara nga qeveria. Të dyja llojet, megjithatë, duhet të jenë të licencuara nga qeveria.¹⁰³

Strehimoret në Kosovë aktualisht strehojnë vetëm fëmijët dhe gratë. Djemtë në strehimore pranohen deri në moshën 12 vjeçare.¹⁰⁴ Tabela 49 ilustron numrin e përgjithshëm të grave dhe fëmijëve të strehuar çdo vit nga strehimoret që marrin financim të pjesshëm nga MPMS-ja. Të gjithë përfituesit kanë qenë gra dhe fëmijë. Duke pasur parasysh se gratë kanë më shumë gjasa të vuajnë nga dhuna se sa burrat, është e qartë se ekziston nevoja për strehim. Megjithatë, nuk ekziston asnjë strehimore për burra dhe djem mbi moshën 18 vjeçare, edhe pse provat tregojnë se ekziston edhe dhuna kundër djemve dhe burrave.¹⁰⁵ Më tej, aktualisht në Kosovë nuk ka strehimore të specializuara për strehimin e lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve (LGBT), edhe pse ekziston dhuna në familje ndaj personave LGBT.¹⁰⁶

Tabela 49. Personat e strehuar me financim të pjesshëm nga MPMS-ja

Viti	# i grave dhe fëmijëve
2008	290
2009	225
2010	229
2011	267
2012	241
2013	268
2014	281

⁹⁹ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 44.

¹⁰⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji Nr 02 / L-17, Neni 1.3d, 12.2.

¹⁰¹ *Programi i Kosovës kundër dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014 dhe Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014.*

¹⁰² RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 23.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit*, Ligji Nr. 04/L-218, Neni 23, 38.

¹⁰⁴ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 34.

¹⁰⁵ RrGGK *Mjaft më me arsye*, 2015. Raportet e policisë gjithashtu sugjerojnë se burrat dhe djemtë janë gjithashtu viktimat e dhunës. Për më shumë shih: Farnsveden, Ulf, Ariana Qosaj-Mustafa, dhe Nicole Farnsworth për Orgut, *Profili Gjinnor i Shtetit*, Prishti marrë nga: Sida, 2014.

¹⁰⁶ RrGGK, *Mjaft më me arsye*, f. 77 dhe 54. Në një hulumtim të ardhshëm, mbi 70% e personave LGBT të intervistuar thanë se "shtëpia" është "vendi më i rrezikshëm" për ta (intervistë me përfaqësuesit e organizatave LGBT, në RrGGK, *Mjaft më me arsye*, f. 77.

Tabela 50 paraqet buxhetin e ndarë nga MPMS-ja për strehimoret në Kosovë prej vitit 2011 deri në vitin 2014.¹⁰⁷ Të gjitha, përpos një strehimoreje, kanë pranuar në vazhdimësi një sasi të barabartë të fondeve gjatë kësaj periudhe, pavarësisht numrit të personave të strehuar.

Tabela 50. Buxheti total i transferuar për secilën strehimore nga MPMS-ja sipas vitit 2011-2015						
Strehimorja	Lokacioni	2011	2012	2013	2014	(plani për vitin) 2015
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)	Prishtinë	17,000€	17,000€	24,000€	24,000€	24,000€
QMGF Raba Voca	Mitrovicë	17,000€	17,000€	24,000€	24,000€	24,000€
Qendra për Mirëqenien e Grave (QMG)	Pejë	17,000€	17,000€	24,000€	24,000€	24,000€
Shtëpia e Sigurt	Gjakovë	17,000€	17,000€	24,000€	24,000€	24,000€
Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve (CSGF)	Prizren	17,000€	17,000€	24,000€	24,000€	24,000€
Qendra Liria	Gjilan	17,000€	17,000€	24,000€	24,000€	24,000€
Objekti i Përkohshëm i Sigurimit ¹⁰⁸		51,469€	62,242€ ¹⁰⁹	80,000€	80,000€	N/A
Mbrojtja e Viktimave dhe Parandalimi i Trafikimit (MVPT)	Prishtinë	21,000€	26,500€	30,000€	30,000€	30,000€
Shtëpi dhe Shpresë për Fëmijët	Prishtinë	N/A	N/A	50,000€	50,000€	N/A
Total		174,469	190,742€	304,000€	304,000€	N/A

Që nga viti 2015, strehimoret që ofrojnë shërbime të financuara nga shteti janë përzgjedhur përmes një procesi të prokurimit përmes të cilit MPMS-ja i blen shërbimet e tyre. MPMS-ja zgjedh strehimoret që përmbushin kriteret e përcaktuara nga MPMS-ja, dhe pastaj nënshkruan MM me këto strehimore.¹¹⁰ Duke filluar nga prilli i vitit 2015, strehimoret kanë filluar marrjen e fondeve të qeverisë në bazë të numrit të personave që ata strehojnë. MPMS-ja paguan 50% të shpenzimeve për gjëra elementare, siç është ushqimi dhe strehimi. Shuma e paguar për strehimore për person të strehuar është 208,33 € në muaj¹¹¹. Tabela 51 tregon shumën e shpërndarë në strehimore nga MPMS-ja për mbrojtjen e personave të cilët kanë vuajtur nga dhuna në familje dhe trafikimi me qenie njerëzore. Sipas përfaqësuesve të MPMS-së, të gjitha strehimoret kanë dëshmuar se ato mund të strehojnë më së shumti 12 njerëz, çka do të thotë se ato marrin një shumë maksimale prej 2,500 € në muaj.

Anëtarët e Koalicionit të Strehimoreve kanë llogaritur se për të strehuar dikë për 24 orë kushton 30 € dhe ofrimi i të gjitha shërbimeve të nevojshme, arrin në 900 € në muaj për person.¹¹² Megjithatë, shpenzimet për personin e strehuar mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, varësisht nga lëndimet e pësura, këshillimeve psikologjik të nevojshme, dhe disa faktorë të tjerë.¹¹³ Prandaj duke bërë vlerësime të sakta të shpenzimeve për të ofruar informata për planifikimin e buxhetit, do të kërkohet monitorim i kujdesshëm i tendencave në shpenzimet aktuale për ofrimin e strehimit me kalimin e kohës (duke përfshirë pajisjet, ushqimin, kujdesin shëndetësor, këshillimin, mundësitë arsimore, dhe trajnimin drejt rehabilitimit dhe reintegrit). Sigurimi i faturave për këto shpenzime nga strehimoret dhe dokumentimi me kujdes i shpenzimeve aktuale mund të ndihmojë që në të ardhmen MPMS-ja të bëjë buxhetim më të mirë për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave të cilët kanë përjetuar dhunë.¹¹⁴

¹⁰⁷ RrGGK, *Buxheti drejt Mirëqenies Sociale*, f. 23.

¹⁰⁸ Këto përfaqësojnë shpenzimet aktuale më shumë se shpenzimet e buxhetuara fillimisht. Numrat janë rrumbullakuar në Euro më të afërt. Financimi për ISF erdhi nga Ministria e Drejtësisë. Burimi: ISF, korrespondencë, maj 2014.

¹⁰⁹ Shuma e buxhetuar ishte 75,000, kështu që ata kaluan shpenzuan më pak se sa ishte buxhetuar fillimisht.

Intervistë me përfaqësuesin e Divizionit për Shërbime Sociale MPMS, nëntor 2015.

¹¹¹ Po aty.

¹¹² RrGGK, *Me çfarë çmimi?* Buxheti për zbatimin e kornizës ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë, Prishtinë marrë nga: RrGGK, 2012, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130405120224756.pdf>, f. 50.

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, *Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014*, f. 33, marrë nga: <http://abgj.rks->

Tabela 51. Pagesat në € të MPMS-së për OJQ-të në vitin 2015¹¹⁵

OJQ	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Gjithsej
QMGF Prishtinë	2,500	2,500	2,500	1,667	2,500	833	2,500	2,500	1,042	18,542
QMGF Mitrovica	2,500	2,500	2,500	1,875	2,083	1,875	1,667	2,500	2,500	20,000
Shtëpia e Sigurt Gjakovë	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	22,500
Liria, Gjilan	2,500	2,500	1,458	1,667	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	13,958
QMG, Pejë	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	22,500
MVPT, Prishtinë	3,000	3,000	750	500	2,500	2,000	2,500	2,000	2,250	18,500
ADD, Ferizaj	1,250	1,245	104	208	520	520	937	521	729	5,309
QSGF, Prizren	2,500	2,500	1,875	1,042	1,245	1,042	833	1,667	833	12,500
Total	19,250	19,250	14,187	9,250	16,353	13,770	15,937	16,687	14,854	133,809

Gjetjet kryesore

- Nga viti 2011 deri në vitin 2015 të gjitha strehimoret, përpos njëres, kanë marrë një shumë të barabartë të fondeve vjetore nga MPMS-ja, pavarësisht nga numri i personave të strehuar. Duke filluar nga viti 2015, MPMS-ja u paguan strehimoreve 208,33 € në muaj për një person të strehuar. Strehimoret kanë pasur përfitues vetëm gra dhe fëmijë. Aktualisht, nuk ka strehimore për burra dhe djem mbi moshën 12 vjeçare. Gjithashtu, nuk ka asnjë strehimore që i plotëson nevojat specifike të personave LGBT. Në aspektin e mbulimit gjeografik, nuk ka strehimore në veri të Kosovës, gjë që i kontribuon mungesës së qasjes në strehim në veçanti për personat serbë që përjetojnë dhunë¹¹⁶

Rekomandimet

- Të planifikohet buxheti për të paktën një strehimore që strehon burrat dhe djemtë mbi moshën 12 vjeç, një strehimore për personat LGBT, dhe një strehimore në veri të Kosovës. Kjo mund të përfshijë kontraktimin e këtyre shërbimeve.
- Të vazhdohet financimi i strehimoreve në bazë të numrit të personave të strehuar. Të bëhen vlerësime të sakta të shpenzimeve të strehimores për person, duke monitoruar me kujdes prirjet në shpenzimet aktuale të ofruara për strehim me kalimin e kohës. Kjo mund ta ndihmojë MPMS-në buxhetimin më të mirë në të ardhmen për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave të cilët kanë përjetuar dhunë.

Divizioni për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe për Persona të Moshuar

Kjo pjesë analizon përfituesit e shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Siç është theksuar në hulumtimin paraprak të RrGGK-së¹¹⁷, është vështirë të merren informata rreth buxhetit për secilin institucion të kujdesit pasi ky buxhet është i centralizuar. Fondet shpërndahen përmes një linje të vetme të buxhetit për të gjitha "Institucionet". Në Tabelën 52 tregohet

gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimet.pdf

¹¹⁵ Shumat janë rrumbullakuar në Euro të afërt nga RrGGK-ja për prezantim.

¹¹⁶ RrGGK, *Mjaft më me arsytetime*.

¹¹⁷ RrGGK, *Buxheti drejt Mirëqenies Sociale*, f. 24.

se në vitin 2015 buxheti për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, përveç subvencioneve dhe transfereve, ka rënë dukshëm. Megjithatë, buxheti i përgjithshëm për këto institucione është rritur më tepër se dy herë. Ky Divizion ka buxhetuar 30,000 € për një transferim 10 € mujor për përfitues, në institucione. Pasi që ky transferim është bërë në para të gatshme, Ministria e Financave e ka ndërprerë atë në vitin 2011 për shkak të parregullsive në Institutin e Shtimes. Nga viti 2011 deri në vitin 2014, kjo shumë u transferua në Divizion, por ajo nuk është shfrytëzuar.¹¹⁸ Hulumtimi paraparak i RrGGK-së vuri në dukje se transferet janë rialokuar dhe janë shpenzuar në kostot e tjera në kuadër të MPMS-së.¹¹⁹ Që nga viti 2016, të gjitha këto institucione do të decentralizohen, me përjashtim të tri prej tyre: Shtëpisë së Pleqeve në Prishtinë, Institutit Special në Shtime, dhe Shtëpisë së Fëmijëve në Shtime, e cila do të mbetet nën MPMS. Të gjitha institucionet e tjera do të decentralizohen plotësisht dhe nuk do të marrin asnjë fond nga MPMS-ja. Ato do të duhet të sigurojnë financimin e tyre, i cili mund të vijë nga komuna apo donatorët, por që do të jetë përgjegjësi e komunave.

Tabela 52. Buxheti në € për institucionet në shërbim të personave me aftësi të kufizuar dhe të moshuarit, 2013-2015 sipas kategorisë ekonomike

Viti	Të punësuarit	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2013	242	1,009,779	768,473	106,664	30,000	400,000	2,314,916
2014	242	966,216	849,510	177,000	30,000	400,000	2,422,726
2015	219	198,581	794,974	155,000	30,000	455,000	2,557,270
2016							1,424,709

Shtëpitë për Personat e Moshuar

Udhëzimi Administrativ nr. 10/2014 për “punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet”¹²⁰ rregullon ofrimin e këtij shërbimi social. Kriteret e pranueshmërisë janë që të gjithë personat e vendosur në shtëpitë e të moshuarve të jenë mbi moshën 65 vjeç, të mos kenë pasardhës biologjikë apo të birësuar, dhe të jenë në gjendje të mirë mendore.¹²¹ Këto kriteret të rrepta mund të nënkuptojnë se disa persona të moshuar në Kosovë janë të detyruar të qëndrojnë në situata të vështira shtëpiake, të cilat mund t'i ekspozojnë ata ndaj rrezikut nga dhuna. Në të njëjtën kohë, nevoja për t'u kujdesur për personat e moshuar mund t'i pengojë njerëzit, veçanërisht gratë, nga pjesëmarrja në fuqinë punëtore.

Aktualisht ka tri shtëpi për persona të moshuar në Kosovë (në Prishtinë, Gurakoc, dhe Skenderaj) dhe një shtëpi të komunitetit në Graçanicë, e cila u hap në vitin 2014. Tabela 53 ilustron numrin e grave dhe burrave të cilët kanë marrë kujdes në këto qendra. Në vitin 2014 dhe 2015, gratë përbënin rreth 56% të përfituesve. Kjo shënoi një rritje në përqindjen e grave përfituese nga 45% që ishte në vitin 2013. Kjo rritje duket se është një kombinim i më shumë grave dhe më pak burrave që kërkojnë këto shërbime. Kjo mund t'i atribuohet pritshmërisë për jetëgjatësi më të madhe të grave apo faktit se në Kosovë ekziston një përqindje pak më e lartë e grave në këtë moshë në krahasim me burrat.¹²²

Pasi që buxheti i shpërndarë për çdo institucion nuk ishte në dispozicion, nuk ka qenë e mundur të llogaritej shuma e shpenzuar për gra dhe burra. Megjithatë, mund të bëhet vlerësim i përafërt në bazë të përqindjes së përfituesve se në vitin 2014, përafërsisht 56% është shpenzuar për gra, ndërsa 44% për burra.

¹¹⁸ RrGGK Intervistë me Udhëheqësin e Divizionit, nëntor 2015.

¹¹⁹ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, f. 25.

¹²⁰ Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr 10/2014, 2014, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10414>.

¹²¹ Po aty. Neni 5.

¹²² Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë, në vitin 2011, 53% e qytetarëve mbi moshën 65 vjeçare ishin gra, ndërsa 47% ishin burra.

Tabela 53. Përfituesit e Qendrave për Kujdes ndaj të Moshuarve sipas Gjinisë

Qendra për kujdes ndaj të moshuarve	Viti	# total i qytetarëve	# total i grave kliente	% e grave kliente	# total i burrave klientë	% e burrave klientë
Prishtinë (135 shtretër)	2012	97	58	60%	39	40%
	2013	93	40	43%	53	57%
	2014	84	47	56%	37	44%
	2015	71	41	58%	30	42%
Gurakoc (20 shtretër)	2012	15	8	53%	7	47%
	2013	16	9	56%	7	44%
	2014	15	8	53%	7	47%
	2015	14	8	57%	6	43%
Skenderaj (20 shtretër)	2012	15	7	47%	8	53%
	2013	14	6	43%	8	57%
	2014	14	8	57%	7	50%
	2015	14	8	57%	7	50%
Graçanicë	2014	15	7	47%	8	53%
	2015	6	2	33%	4	67%
Total në Kosovë	2012	127	73	57%	54	43%
	2013	123	55	45%	68	55%
	2014	108	61	56%	47	44%
	2015	105	59	56%	47	45%

Gjetjet kryesore

- Ekzistojnë shumë pak shtëpi për persona të moshuar dhe me aftësi të kufizuara në krahasim me madhësinë e mundshme të grupit të synuar. Kriteret për shfrytëzimin e shtëpive të tilla janë të rrepta dhe si të tilla ato mund t'i ekspozojnë personat e moshuar ndaj rrezikut që të qëndrojnë në situata të vështira në shtëpi.

Rekomandimet

- Investimi në qendrat e kujdesit, të paktën për kujdes gjatë ditës, me kriteret më pak të rrepta mund të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe pavarësisë së personave të moshuar, të krijojë vende pune, dhe t'u mundësojë personave që aktualisht kujdesen për personat me aftësi të kufizuara apo për persona të moshuar të marrin pjesë në fuqinë punëtore.

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës është përgjegjës për politikën që kanë të bëjnë me personat e prekur nga lufta, duke përfshirë invalidët e luftës, viktimat civile, familjet e tyre të mbijetuara, dhe të viktimave të dhunës seksuale të luftës.¹²³ Tri llojet e pensioneve mund të jepen sipas kësaj skeme: pensionet familjare (për anëtarët e ngushtë të familjes), pensione personale për aftësi të kufizuara (për vetë personat me aftësi të kufizuara), dhe pensioni invalidor familjar (për familjen e personit me aftësi të kufizuara, pas vdekjes së personit me aftësi të kufizuara).¹²⁴ Kjo pjesë shqyrton secilin nga këto lloje të përfitimeve *vis-à-vis* grupeve të synuara. Përafërsisht, 13,517 persona

¹²³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/ L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, 2011, marrë nga: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20the%20status%20of%20the%20martyrs.pdf> dhe Ligji Nr 04/ L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 4/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, 2014, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-172%20a.pdf>.

¹²⁴ Po aty. Neni 5.

kanë vdekur, janë vrarë, ose janë zhdukur gjatë luftës në Kosovë në mes të periudhës 1 janar 1998 dhe 4 qershor 1999, dhe pas hyrjes së trupave ndërkombëtare në Kosovë deri në dhjetor 2000¹²⁵. Është vlerësuar që rreth 12,000 shqiptarë dhe më shumë se 3,000 serbë kanë humbur jetën, në mes të personave të përkatësive të tjera etnike.¹²⁶

Tabela 54 paraqet shpenzimet e mëhershme dhe të planifikuara për të ardhmen për këtë Departament. Numri i përfituesve të disa pensioneve të elaboruara më poshtë është parashikuar të rritet në vitet e ardhshme, i shoqëruar me një rritje në subvencione dhe transfere në kategorinë e shpenzimeve. Përmes Vendimit 171 (2011)¹²⁷ të Qeverisë, MPMS-ja nuk ka lejuar aplikacione të reja për skemat pensionale të ofruara nga ky departament. Megjithatë, në vitin 2014, përmes një vendimi tjetër, ish-ministri i MPMS-së, Nenad Rashiq mundësoi aplikacione të reja për skemat e mëposhtme të pensionit: viktima civile, familje të dëshmorëve, invalidë të UÇK-së, dhe veteranë të luftës, nga marsi 2014. Kjo e shpjegon rritjen e përfituesve dhe buxhetin në periudhën pas vitit 2014.¹²⁸ Rritje e mëtejshme e buxhetit parashikohet në vitet e ardhshme për pjesën më të madhe të kategorive pensionale, të financuara nga ky Departament, siç është detajuar më poshtë.

Familjet e Dëshmorëve

Ky pension merret nga anëtarët e familjes së ngushtë të familjeve të dëshmorëve të luftës. Nga 1,977 persona që e pranojnë këtë pension në vitin 2015, 78% janë gra, ndërsa 22% janë burra (shih Tabelën 55). Kjo përqindje nuk ka ndryshuar dukshëm dhe zyrtarët planifikojnë që ajo të mbetet e ngjashme në vitin 2018. Fakti që më shumë gra përfitojnë nga ky pension nuk është befasisht duke pasur parasysh se më shumë burra luftuan në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), kështu që anëtarët në vartësi në familjen e tyre të ngushtë kanë më shumë gjasa të jenë gra. Për arsye të ngjashme,

ndoshta nuk është befasisht se gratë shqiptare kanë marrë përqindjen më të lartë të këtij pensioni (78%), pasuar nga burrat shqiptarë (22%), dhe disa gra nga grupet e tjera etnike (0.15% e përfituesve).

Tabela 54. Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës Shpenzimet e planifikuara dhe aktuale, 2011-2018

Viti	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuar	Diferenca në %
2011	29,921,019€	29,249,970€	97.8%
2012	30,121,019€	30,205,298€	99.7%
2013	30,364,117€	30,364,117€	103.1%
2014	37,309,231€	37,309,226€	99.9%
2015 (Shtat.)	40,663,639€	25,343,673€	62.3%
2016	38,143,191€		
2017	40,143,191€		
2018	40,143,191€		

Tabela 55. Përfituesit e pensioneve të ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Gjithsej Përfitues	Burra %	Gra %	B. shqip.	B. shqip. %	Gra shqip.	Gra shqip. %	Gra tjera	% e grave të tjera
2013	2,020	23%	77%	461	23%	1,556	77%	3	0.15%
2014	2,001	22%	78%	443	22%	1,555	78%	3	0.15%
2015	1,977	22%	78%	426	22%	1,548	78%	3	0.15%
2016	2,088	25%	75%	520	25%	1,565	75%	3	0.14%
2017	2,088	25%	75%	520	25%	1,565	75%	3	0.14%
2018	2,088	25%	76%	520	25%	1,565	75%	3	0.14%

¹²⁵ Qendra për të Drejtën Humanitare, *Libri i Kujtimeve të Kosovës 1998-2000*, Qendra për të Drejtën Humanitare, n.d., në: http://www.kosovskaknjigapamcenja.org/?page_id=107&lang=de.

¹²⁶ Douarin, E., Litchfield, J. dhe Sabates-Wheeler, R., 2010, *Varfëria, jetesa dhe trashëgimia e luftës: rasti i Kosovës Rurale së Pas-luftës*, Hulumtimi 37 në proces i MICROCON, Brighton: MICROCON. RrGGK kishte vështirësi të gjente burime të besueshme dhe informata lidhur me numrin aktual të personave që kanë vdekur apo janë lënduar gjatë luftës, përfshirë informatat e ndara sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe shtrirjes gjeografike.

¹²⁷ MPMS, Vendim 171, 2011.

¹²⁸ MPMS, Vendimi për shfuqizimin e vendimit të MPMS 171, Protokoll Nr. 98, mars 2014.

Gjithsej, 931,690 € janë ndarë për këtë pension në vitin 2015. Bazuar në përqindjen e lartpërmendur të përfituesve, rreth 22% e këtij buxheti ishte marrë nga burrat shqiptarë, 78% nga gratë shqiptare, dhe 0.15% nga gratë e grupeve të tjera etnike (duke mos përfshirë serbët, romët, ashkalinjtë, ose egjiptianët).

Siç ilustron në Tabelën 56, gratë (shqiptare) rurale, kishin prirje të përbënin shumicën e përfituesve (54% në vitin 2015), pasuar nga banoret (shqiptare) urbane (25%), pastaj banorët (burra) ruralë (15%), dhe në fund banorët burra urbanë (6%). Duke pasur parasysh natyrën specifike të këtij pensioni, do të ishte e vështirë të bëheshin rekomandime për çdo ndryshim, por të kuptuarit se kush janë përfituesit kryesorë është i dobishëm në vetvete, me qëllim që të sigurohet që nevojat e tyre të veçanta të plotësohen me shpërndarjen e këtij pensioni.

Tabela 56. Përfituesit e pensioneve të ndarë sipas gjinisë dhe vendndodhjes gjeografike

Viti	Gjithsej përfitues	Burra rural	%	Burra urban	%	Gra rurale	%	Gra urbane	%
2013	2,020	334	17%	127	6%	1,073	53%	486	24%
2014	2,001	314	16%	129	6%	1,066	53%	429	21%
2015	1,977	302	15%	124	6%	1,059	54%	492	25%
2016	2,088	375	18%	145	7%	1,063	51%	505	24%
2017	2,088	375	18%	145	7%	1,063	51%	505	24%
2018	2,088	375	18%	145	7%	1,063	51%	505	24%

Viktimat civile

Përfituesit e kësaj skeme pensionale përfshijnë të afërmit e viktimave civile të luftës. Shumica e përfituesve të këtij pensioni nga viti 2013 deri në vitin 2015 kanë qenë gra (84% -85%). Nga kjo, mund të vlerësohet se burrat kanë marrë afërsisht 16% të 851.577 € të ndara për këtë pension (136.252 €), ndërsa gratë 84% (715.324 €). Departamenti ka planifikuar që përqindja e grave të mbetet e njëjtë në vitet e ardhshme, duke përfshirë edhe një rritje të planifikuar në numrin e përgjithshëm të përfituesve. Gratë shqiptare përbënin 83% të përfituesve. Burrat shqiptarë janë përfituesit më të shpeshtë në vijim (16%). Burrat serbë, gratë serbe, burrat dhe gratë rome, ashkali, egjiptianë, dhe burrat dhe gratë nga grupet e tjera etnike, të gjithë, përbëjnë më pak se një për qind të përfituesve, (shih Tabelën 57).

Tabela 57. Përfituesit e pensioneve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Total	B. shq.	B. shq.	G. shq.	G. shq.	B. ser.	B. ser.	G. ser.	G. ser.	B. RAE	B. RAE	F, RAE	F, RAE	B. të tjerë	B. të tjerë	G. të tjerë	G. të tjerë
2013	4,914	804	16%	4,081	83%	3	0.06%	17	0.35%	1	0.02%	4	0.08%	1	0.02%	3	0.06%
2014	4,811	771	16%	4,010	83%	3	0.06%	17	0.35%	1	0.02%	4	0.08%	1	0.02%	4	0.08%
2015	4,656	739	16%	3,890	84%	4	0.09%	14	0.30%	1	0.02%	3	0.06%	1	0.02%	4	0.09%
2016	5,361	769	14%	4,534	85%	6	0.11%	39	0.73%	2	0.04%	6	0.11%	1	0.02%	4	0.07%
2017	5,361	769	14%	4,534	85%	6	0.11%	39	0.73%	2	0.04%	6	0.11%	1	0.02%	4	0.07%
2018	5,361	769	14%	4,534	85%	6	0.11%	39	0.73%	2	0.04%	6	0.11%	1	0.02%	4	0.07%

Duke pasur parasysh natyrën e luftës, gjithashtu nuk është befasuese që gratë rurale përbëjnë shumicën e përfituesve të pensioneve (58% në vitin 2015) pasi civilët burra ruralë kishin humbur jetën e tyre në shkallë më të lartë se burrat urbanë (shih Tabelën 58). Burrat ruralë marrin përqindjen e ardhshme më të lartë të përfitimeve (12%), të pasuar nga një përqindje e barabartë e grave dhe burrave urbanë (4%), respektivisht.

Tabela 58. Përfituesit e pensioneve të viktimave civile sipas gjinisë dhe vendndodhjes gjeografike

Viti	Gjithsej përfitues	Burra ruralë	%	Burra urbanë	%	Gratë rural	%	Gratë urbane	%
2013	4,914	614	12%	195	4%	2,801	57%	1,304	4%
2014	4,811	586	12%	190	4%	2,755	57%	1,280	4%
2015	4,656	560	12%	185	4%	2,678	58%	1,233	4%
2016	5,361	580	11%	198	4%	2,788	52%	1,795	4%
2017	5,361	580	11%	198	4%	2,788	52%	1,795	4%
2018	5,361	580	11%	198	4%	2,788	52%	1,795	4%

Përsëri, për shkak të natyrës specifike të këtij pensioni të veçantë, nuk mund të bëhet asnjë rekomandim.

Invalidët e UÇK-së

Përfituesit e këtij pensioni përfshijnë personat që u bënë me aftësi të kufizuara gjatë luftës dhe kanë mbetur me aftësi të kufizuara. Shuma mujore e transferuar varet nga niveli i lëndimit të trupit të invalidit të UÇK-së.¹²⁹ Tabela 59 më poshtë tregon se shumica dërrmuese (98%) e përfituesve janë burra. Buxheti i ndarë për vitin 2015 është 1.050.845 €. Shumica e përfituesve janë shqiptarë (që marrin 98% të buxhetit). Gratë shqiptare marrin 2% të buxhetit, ndërsa burrat nga etnitë e tjera serbe, egjiptiane, rome, ashkali marrin 0.1%.

Viti	Gjithsej përfitues	Burra %	Gratë %	B. shq.	B. shq. %	G. shq.	G. shq. %	B. tjerë	%
2013	3,488	98%	2%	3,430	98%	56	2%	2	0.06%
2014	3,464	98%	2%	3,406	98%	56	2%	2	0.06%
2015	3,408	98%	2%	3,352	98%	54	2%	2	0.06%
2016	3,524	98%	2%	3,459	98%	63	2%	2	0.06%
2017	3,524	98%	2%	3,459	98%	63	2%	2	0.06%
2018	3,524	98%	2%	3,459	98%	63	2%	2	0.06%

Duke pasur parasysh përsëri natyrën e luftës nuk është befasuese që shumica e përfituesve të pensioneve të invalidëve të UÇK-së janë burra ruralë (69%), pasuar nga burrat urbanë (30%). Meqenëse për UÇK-në luftuan pak gra, numri i grave që u plagosën është më i vogël sesa ai i burrave. Gratë rurale dhe urbane përbëjnë më pak se 1% të përfituesve (shih Tabelën 60). Duke pasur parasysh natyrën e këtij pensioni, përfituesit do të mbesin të ngjashëm.

Viti	Gjithsej përfitues	Burra ruralë	%	Burra urbanë	%	Gra rurale	%	Gra urbane	%
2013	3,488	2,398	69%	1,034	30%	28	0.80%	28	0.80%
2014	3,464	2,373	69%	1,035	30%	28	0.81%	28	0.81%
2015	3,408	2,337	69%	1,017	30%	27	0.79%	27	0.79%
2016	3,524	2,356	67%	1,105	31%	33	0.94%	30	0.85%
2017	3,524	2,356	67%	1,105	31%	33	0.94%	30	0.85%
2018	3,524	2,356	67%	1,105	31%	33	0.94%	30	0.85%

Invalidët civilë

Nga kjo skemë e pensioneve përfitojnë civilët të cilët kanë aftësi të kufizuara si pasojë e luftës. Sipas Ligjit nr. 04/L-054, shumica e marrë nga çdo person përcaktohet nga niveli i tyre i lëndimit të trupit.¹³⁰ Tabela 61 tregon se burrat janë përfituesit kryesorë të kësaj skeme, që marrin 72% të këtij pensioni. Numri i përfituesve parashihet të rritet në vitin 2016

Viti	Gjithsej përfitues	Burra	Burra %	Gra	Gra %
2013	2,137	1,530	72%	607	28%
2014	2,128	1,523	72%	605	28%
2015	2,068	1,479	72%	589	28%
2016	2,219	1,556	70%	663	30%
2017	2,219	1,556	70%	663	30%
2018	2,219	1,556	70%	663	30%

¹²⁹ Sipas Ligjit Nr. 04/L-054, pensionet variojnë nga 180 € për invalidët me 20% -30% lëndime trupore, deri më 350,50 € për invalidët me lëndim trupor mbi 80%.

¹³⁰ Shumat që transferohen në muaj variojnë prej 96 € për personat me 40-60% lëndime trupore, për 122 € për personat me lëndime trupore mbi 80%.

për shkak të një vendimi të ri të MPMS-së që lejon aplikacione të reja për këtë skemë nga viti 2014 e këtej. Edhe pse mund të duket e çuditshme që mund të ketë invalidë civilë të rinj nga konflikti i viteve 1990, përfaqësuesit e MPMS-së përmendin shkëlqen në fushat e minuara si shembull të shkakut pse ata vazhdojnë të presin në zyrat e tyre parashtrues të rinj potencialë. Buxheti i ndarë për këtë skemë në vitin 2015 ishte 275,626€. Burrat morën rreth 71% të këtij buxheti (195,694.46 €), ndërsa gratë 29% (79,931.54 €). Sa i përket përkatësisë etnike, shumica e përfituesve janë burra shqiptarë (71%) dhe gra shqiptare (28%). Këtë pension e marrin vetëm fare pak burra serbë, gra serbe, apo gra të grupeve të tjera etnike.

Tabela 62. Përfitimet e invalidëve civilë të ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Gjithsej	B. shq.	B. shq. %	G. shq.	G. shq. %	B. serbë	%	Gratë serbe	%	Gratë tjera	%
2013	2,137	1,527	71%	604	28%	3	0.14%	2	0.09%	1	0.05%
2014	2,128	1,520	71%	602	28%	3	0.14%	2	0.09%	1	0.05%
2015	2,068	1,476	71%	586	28%	3	0.15%	2	0.10%	1	0.05%
2016	2,219	1,553	70%	660	30%	3	0.14%	2	0.09%	1	0.05%
2017	2,219	1,553	70%	660	30%	3	0.14%	2	0.09%	1	0.05%
2018	2,219	1,553	70%	660	30%	3	0.14%	2	0.09%	1	0.05%

Burrat shqiptarë ruralë kanë përfituar një pjesë pak më të madhe të këtij pensioni. Burrat urbanë marrin pjesën tjetër më të madhe të përfitimeve të përgjithshme (20%), të pasuar menjëherë nga gratë rurale (19%) dhe gratë urbane (10%). Duke pasur parasysh natyrën e këtij pensioni, nuk mund të bëhet ndonjë rekomandim.

Tabela 63. Përfitimet e invalidëve civilë të ndarë sipas gjinisë dhe vendndodhjes gjeografike

Viti	Gjithsej përfitues	Burrat ruralë	%	Burrat urbanë	%	Gratë rurale	%	Gratë urbane	%
2013	2,137	1,112	52%	418	20%	404	19%	203	9%
2014	2,128	1,105	52%	418	20%	400	19%	205	10%
2015	2,068	1,080	52%	392	19%	399	19%	197	10%
2016	2,219	1,132	51%	427	19%	432	19%	228	10%
2017	2,219	1,132	51%	427	19%	432	19%	228	10%
2018	2,219	1,132	51%	427	19%	432	19%	228	10%

Personat e zhdukur të UÇK-së

Kjo skemë pensioni ofrohet për familjet e pjesëtarëve të zhdukur të UÇK-së. Të dhënat e marra nga MPMS-ja tregojnë se të gjithë personat e regjistruar të zhdukur që luftuan në UÇK janë shqiptarë. Sipas Nr. 04/L-054, shumica e transferuar mujore varet nga numri i njerëzve të cilët janë zhdukur nga secila familje.¹³¹ Kjo skemë ka 20 përfitues, 90% e të cilëve janë gra dhe 10% burra. Ky numër dhe përqindje ka mbetur i qëndrueshëm me kalimin e kohës dhe ka të ngjarë të mbetet i njëjtë edhe në të ardhmen.

Buxheti i ndarë për këtë skemë në vitin 2015 ishte 9,948.48 €. Burrat shqiptarë morën 14% (1,392.79 €), ndërsa gratë shqiptare morën 86% (8,555.69 €) të kësaj ndarjeje.

Tabela 64. Përfituesit e pensionit për personat e zhdukur të UÇK-së sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Gjithsej përfitues	Burra shqiptarë	Burra %	Gratë shqiptare	Gratë %
2013	20	2	10%	18	90%
2014	20	2	10%	18	90%
2015	20	2	10%	18	90%
2016	20	2	10%	18	90%
2017	20	2	10%	18	90%
2018	20	2	10%	18	90%

¹³¹ Shumat që transferohen në muaj variojnë nga 358,50 € për një person të zhdukur për familje deri 534,00 € për familjet me më shumë se katër persona të zhdukur.

Tabela 65 tregon se shumica e përfituesve të këtij pensioni janë gra nga zonat rurale (65%), pasuar nga gratë urbane (25%). Duke pasur parasysh natyrën e këtij pensioni, nuk mund të bëhet asnjë rekomandim.

Viti	Gjithsej përfitues	Burrat ruralë	%	Burrat urbanë	%	Gratë rurale	%	Gratë urbane	%
2013	20	1	5%	1	5%	13	65%	5	25%
2014	20	1	5%	1	5%	13	65%	5	25%
2015	20	1	5%	1	5%	13	65%	5	25%
2016	20	1	5%	1	5%	13	65%	5	25%
2017	20	1	5%	1	5%	13	65%	5	25%
2018	20	1	5%	1	5%	13	65%	5	25%

Personat e zhdukur civilë

Pensioni për Persona të Zhdukur Civilë u shpërndahet familjeve të personave të zhdukur civilë. Sipas Ligjit Nr. 04/L-054, shuma e transferuar për familjet me persona civilë të zhdukur është 135 €. Sipas Komitetit Ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq, 1,655 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur në vitin 2014 (shqiptarë, serbë dhe përkatësi të tjera etnike).¹³²

Në përgjithësi 82% e 351 përfituesve të këtij pensioni në vitin 2014 ishin gra dhe 18% burra. 70% e përfituesve të pensioneve janë pjesëtarë të familjeve të tyre, domethënë gra shqiptare. Burrat shqiptarë përbëjnë 16% të përfituesve, gratë serbe 11%, burrat serbë 2%, dhe gratë e grupeve etnike të tjera më pak se një për qind (shih Tabelën 66). Mund të vlerësohet me përafërsi se e njëjta përqindje e subvencioneve dhe transfereve të buxhetit për këtë pension shpërndahet për secilin nga grupet e lartpërmendura.

Viti	Gjiths ej	B. %	G. %	B. shq.	B. shq %	G. shq.	G. shq. %	B. ser.	%	G. ser.	%	G. RAE	%	G. tjera	G. tjera
2013	321	20%	80%	62	19%	245	76%	3	0.9%	8	2%	0	0%	3	0.9%
2014	351	18%	82%	57	16%	246	70%	7	2.0%	37	11%	1	0.28%	3	0.85%
2015	354	17%	83%	54	15%	248	70%	7	2.0%	41	12%	1	0.28%	3	0.85%
2016	1,994	13%	87%	234	12%	1,604	80%	26	1.3%	120	6%	5	0.25%	5	0.25%
2017	1,994	13%	87%	234	12%	1,604	80%	26	1.3%	120	6%	5	0.25%	5	0.25%
2018	1,994	13%	87%	234	12%	1,604	80%	26	1.3%	120	6%	5	0.25%	5	0.25%

Pasi personat e zhdukur janë kryesisht nga zonat rurale, anëtarët e familjes në zonat rurale marrin pjesën më të madhe të këtij pensioni (45% në vitin 2014). Gratë urbane marrin përqindjen tjetër më të lartë (37%), pasuar nga burrat ruralë (12%), dhe burrat urbanë (7%).

Viti	Gjithsej	B. ruralë	%	B. urbanë	%	Gratë rurale	%	Gratë urbane	%
2013	321	42	13%	23	7%	109	34%	147	46%
2014	351	41	12%	24	7%	158	45%	129	37%
2015	354	42	12%	19	5%	164	46%	129	36%
2016	1994	196	10%	64	3%	1245	62%	489	25%
2017	1994	196	10%	64	3%	1245	62%	489	25%
2018	1994	196	10%	64	3%	1245	62%	489	25%

Nga viti 2016, numri i përfituesve të këtij pensioni pritet të rritet në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha llojet e përfituesve, por në veçanti për gratë shqiptare të zonave rurale. Kjo rritje pritet për

¹³² Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq, 18 nëntor 2014, në: https://www.icrc.org/en/document/western-balkans-after-15-years-more-1600-people-still-missing-kosovo#.VGxTJfmG_V8.

shkak të vendimit të ri të MPMS-së cili lejon aplikimet e reja për këtë lloj të pensionit duke filluar nga viti 2014.¹³³

Familjet e invalidëve të vdekur të luftës

Familjet e marrin këtë pension pas vdekjes së invalidit të luftës. Në vitin 2015, buxheti i ndarë për këtë skemë ishte 35,304 €. Tabela 68 paraqet se 91-92% e përfituesve kanë qenë gra, në krahasim me 8-9%, të cilët kanë qenë burra. Gratë shqiptare morën 89% të subvencioneve dhe transfereve (31.42 €), ndërsa burrat shqiptarë morën 10% (3530 €).

Viti	Gjithsej përfitues	% e burrave	% e grave	B. shq.	% e b. shq.	G. shq.	% e g. Shq.	B. të tjerë	% e b. të tjerë
2013	106	8%	92%	8	8%	97	92%	1	0.9%
2014	124	9%	91%	11	9%	113	91%	1	0.8%
2015	133	9%	91%	12	9%	121	91%	1	0.8%
2016	149	8%	92%	12	8%	137	92%	1	0.7%
2017	149	8%	92%	12	8%	137	92%	1	0.7%
2018	149	8%	92%	12	8%	137	92%	1	0.7%

Familjet e invalidëve të vdekur civilë

Përfituesit e kësaj skeme pensionale përfshijnë anëtarët e ngushtë të familjes së invalidëve civilë, pasi ky person ka vdekur. Tabela 69 tregon se shumica e përfituesve kanë qenë gra (83-84%). Buxheti i përgjithshëm i ndarë për këtë skemë në vitin 2015 ishte 10,238 €. Gratë shqiptare kanë marrë 84% të këtyre fondeve (8702 €), në krahasim me 16% të marra nga burrat shqiptarë (1,638 €) dhe 1% nga jo-serbë, gratë e pakicës jo-RAE (102,38 €).

Tabela 69. Përfituesit e pensioneve të familjeve të invalidëve të vdekur civilë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Gjithsej përfitues	B. shq.	%	G. shq.	%	Gra të tjera	%
2013	77	12	16%	65	84%	0	
2014	86	16	19%	70	81%	1	1%
2015	93	15	16%	78	84%	1	1%
2016	103	17	17%	86	83%	1	1%
2017	103	17	17%	86	83%	1	1%
2018	103	17	17%	86	83%	1	1%

Përfituesit e pensionit jetojnë kryesisht në zonat rurale ku gratë e zonave rurale marrin 55% të fondeve në vitin 2015, pasuar nga gratë urbane që marrin 29% të fondeve, burrat ruralë marrin 13%, dhe burrat urbanë 3%.

Tabela 70. Përfituesit e pensioneve të familjeve të invalidëve të vdekur civilë sipas vendndodhjes dhe gjinisë

Viti	Gjithsej	Burra ruralë	%	Burra urbanë	%	Gra rurale	%	Gra urbane	%
2013	77	8	10%	4	5%	41	53%	24	31%
2014	86	12	14%	4	5%	44	51%	26	30%
2015	93	12	13%	3	3%	51	55%	27	29%
2016	103	13	13%	4	4%	58	56%	29	28%
2017	103	13	13%	4	4%	58	56%	29	28%
2018	103	13	13%	4	4%	58	56%	29	28%

Numri i përfituesve të pensioneve pritet të rritet pak në vitin 2016, por përqindja e përfituesve sipas përkatësisë etnike dhe vendndodhjes gjeografike pritet të mbetet e njëjtë.

¹³³ Intervistë e RrGGK, nëntor 2015.

Kujdestarët e invalidëve civilë

Kjo skemë shërben për kujdestarët e civilëve që u bënë invalidë si pasojë e luftës. Sipas Ligjit Nr. 04/L-054, invalidët civilë të cilët pësuan lëndime në 80% të trupit të tyre për shkak të luftës kanë të drejtë të përfitojnë kujdesin. Kujdestarët mund të jenë anëtarë të familjes, ose, në mungesë të anëtarëve të familjes, punonjësit socialë. Transferi mujor për një kujdestar është 40,10 €. Tabela 71 ilustron se gratë kanë përbërë shumicën e kujdestareve dhe në këtë mënyrë kanë marrë shumicën e subvencioneve dhe transfereve në lidhje me këtë pension (61-65%). Gratë morën 58% të 1,905 € të ndara në vitin 2015 (1,105 €), ndërsa burrat shqiptarë morën (800 €).

Sa i përket vendndodhjes gjeografike, gratë e zonave rurale përbënin 47% të kujdestarëve në vitin 2015, burrat ruralë 33%, gratë urbane 14%, dhe burrat urbanë 6% (shih Tabelën 72).

Numri i përfituesve pritet të rritet pak në vitin 2016 dhe të mbetet i njëjtë gjatë vitit 2018, me rritje relativisht më të madhe në krahasim me përqindjen e grave kujdestare shqiptare.

Tabela 71. Përfituesit e pensioneve të kujdestarëve të civilëve invalidë sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë

Viti	Gjithsej përfitues	B. shq.	%	G. shq.	%
2013	36	14	39%	22	61%
2014	36	13	36%	23	64%
2015	36	14	39%	22	61%
2016	43	15	35%	28	65%
2017	43	15	35%	28	65%
2018	43	15	35%	28	65%

Tabela 72. Përfituesit e pensioneve të kujdestarëve të civilëve invalidë sipas gjinisë dhe vendndodhjes

Viti	Gjithsej	Burra ruralë	%	Burra urban	%	G. rurale	%	G. urbane	%
2013	36	12	33%	2	6%	17	47%	5	14%
2014	36	11	31%	2	6%	18	50%	5	14%
2015	36	12	33%	2	6%	17	47%	5	14%
2016	43	12	28%	2	5%	21	49%	7	16%
2017	43	12	28%	2	5%	21	49%	7	16%
2018	43	12	28%	2	5%	21	49%	7	16%

Kujdestarët e Invalidëve të Luftës

Sipas Ligjit nr. 04/L-054, invalidët e luftës të cilët kanë lëndime mbi 80% të trupit të tyre kanë të drejtë për kujdestarë. Kujdestarët mund të jenë anëtarë të familjes, ose, në mungesë të anëtarëve të familjes, punonjësit socialë. Invalidët e luftës që kanë pësuar lëndime në më shumë se 80% të trupit të tyre kanë të drejtë për një kujdestar që merr 180 € në muaj. Personat që kujdesen për invalidët e luftës të cilët kanë aftësi të kufizuara që rrjedhin nga lufta marrin këtë pension. Veçanërisht, pensioni për kujdestarët e invalidëve të luftës është 4.5 herë më i lartë se pensioni për kujdestarët e civilëve. Megjithatë, përgjegjësitë dhe puna e kryer nga një kujdestar në secilin rast është e ngjashme. Në kuadër të pagesës së barabartë për punë të barabartë, kjo duket diskriminuese ndaj kujdestarëve të civilëve, të cilët kanë tendencë të jenë gra.

Tabela 73 tregon se shumica e përfituesve të këtij pensioni gjithashtu kanë qenë gra (79-82%). Në vitin 2015, nga 17.325 € të ndara për këtë pension, gratë shqiptare kanë marrë 77% (13.340 €), burrat shqiptarë 22% (3812 €), dhe gratë nga pakicat tjera jo-serbe, jo RAE 1% (173 €). Numri i përfituesve pritet të rritet pak në vitin 2016 dhe mbetet konstante deri në vitin 2018 me një përqindje të ngjashme të subvencioneve dhe transfereve të shpërndara grupeve të lartpërmendura etnike.

Tabela 73. Përfituesit e pensioneve për kujdestarët e invalidëve të luftës sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Viti	Gjiths ej	Burra %	Gra %	B. shq.	% B. shq.	G.shq.	% G.shq.	G. tjera	%
2013	76	18%	82%	14	18%	61	80%	1	1%
2014	75	20%	80%	15	20%	59	79%	1	1%
2015	75	21%	79%	16	21%	58	77%	1	1%
2016	81	21%	79%	17	21%	63	78%	1	1%
2017	81	21%	79%	17	21%	63	78%	1	1%
2018	81	21%	79%	17	21%	63	78%	1	1%

Gjetjet kryesore

- Shumica e përfitimeve nga ky departament shkojnë teg gratë shqipëtare rurale, edhe pse edhe të tjerët i gëzojnë këto përfitime.
- Gratë shqiptare, kryesisht nga zonat rurale, përbëjnë shumicën e kujdestareve të personave me aftësi të kufizuara që rrjedhin nga lufta. Pensioni për kujdestarët e invalidëve të luftës është 4.5 herë më i lartë se pensioni për kujdestarët e invalidëve civilë. Megjithatë, përgjegjësitë dhe puna e kryer nga kujdestari janë të ngjashme. Duke pasur parasysh parimin "pagë e barabartë për punë të barabartë", kjo duket diskriminuese ndaj kujdestarëve të civilëve, të cilat kryesisht janë gra.

Rekomandimet

- Informatat demografike në lidhje me përfituesit e këtyre pensioneve mund të jenë të dobishme për të siguruar që ata të kenë qasje të lehtë në shërbimet që kanë të bëjnë me këto pensione, duke pasur parasysh nevojat e tyre specifike.
- Të merret parasysh ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës për të garantuar pagë të barabartë për punë të barabartë, të kryer nga të gjithë kujdestarët e personave që kanë pësuar lëndime gjatë luftës. Pensioni i MPMS-së për invalidët e luftës në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ekonomike është paraparë të jetë 38,000,000 € për vitin 2016 dhe që të adresojë këtë pabarazi duhet të rritet për 72,240 €.

Bibliografia

- Ajencia e Statistikave të Kosovës, "Statistikat gjinore në Kosovë", nga Sanije Uka 2014, marrë nga: http://www.instat.gov.al/media/257404/gender_statistics_in_kosovo.pdf
- _____, "Seria 1, Statistikat e përgjithshme, Kosova në shifra 2012" 12 qershor 2013, marrë nga: https://ask.rks-gov.net/publikimet/doc_download/1006-kosova-naeuml-shifra-2012.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr 15/2009, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.15-2009%20Për%20Rritjen%20e%20pensioneve%20për%20zbatimin%20e%20Vendimit%20të%20Qeverisë%20Nr.02-51.pdf>.
- _____. *Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015* marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-172%20sh.pdf>.
- Ligji i Kosovës për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar 2003, Nr. 2003/33, marrë nga: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_23_al.pdf.
- _____. Ligji i Kosovës për Barazi Gjinore, 2015, Nr. 05/L-020, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20sh.pdf>
- _____. Ligji i Kosovës për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me paaftësi të përhershme, Nr 03/ L-022, marrë nga: http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=260&Itemid=28&lang=sq.
- _____. Ligji i Kosovës mbi Pensionet e Pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, 2008, Nr. 03 / L-100, marrë nga: http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=278&lang=sq
- _____. Ligji i Kosovës për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, 2012, Nr 04/L-084, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2818>
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz të Kosovës Nr. 04 / L-218, marrë nga: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Ligji_kunder_trafikimit-shqip.pdf.
- _____. Ligji i Kosovës për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, 2003, Nr. 2003/15, marrë nga: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_15_al.pdf.
- _____. Ligji i Kosovës për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, 2011, Nr 04/L-054, marrë nga: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20the%20status%20of%20the%20martyrs.pdf> dhe Ligji Nr 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë, 2012, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Pension%20Funds%20of%20Kosovo.pdf>.
- _____. Ligji i Kosovës për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr. 02/ L-17, marrë nga: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_al.pdf.
- _____. Ligji i Kosovës për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Nr, 2003/15, marrë nga: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2003_15_al.pdf
- Komisioni Evropian, Objektivat Barcelona, Belgjikë: Komisioni Evropian, 2013, marrë nga: http://eurogender.eige.europa.eu/sites/default/files/130531_barcelona_en.pdf.
- Farsvenden, Ulf Nicole Farnsworth dhe Ariana Qosaj-Mustafa për Orgut, Profili Gjinnor i Vendit, Prishtinë: Sida, 2014, marrë nga: <http://womensnetwork.org/documents/20140513160130237.pdf>.
- Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948, në: <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/index.html>.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr .10/2014, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10414>.
- _____, Udhëzimi Administrativ Nr 10/2007 për pensionet e parakohshme për punëtorët e kompleksit të Trepçës dhe minierave të tjera nëntokësore në Kosovë, 2007, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Sekondar/U.A%20Nr.10-2007%20P%C3%ABr%20Pensionim%20t%C3%AB%20Parakohsh%C3%ABm%20p%C3%ABr%20Pun%C3%ABtor%C3%ABt%20e%20Kompleksit%20TREPCA.pdf>.
- _____, *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimt kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014*, marrë nga: <https://www.mpb-ks.org/repository/docs/TQNJShqip.pdf>
- _____, *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018*, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_2015-2018__10_mars.pdf.
- _____, *Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimt 2011-2014*, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Pension%20Funds%20of%20Kosovo.pdf>.

- _____, Rregullorja Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, 2011, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miraturar_nga_Qeveria_finale.pdf.
- _____, *Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale në Kosovë 2013-2017*, Zhvilluar nga Komisioni Këshillimor për politika vendore për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale, shtator 2012, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Decentralizimin_e_Sherbimeve_Sociale_ne_Kosove_2013-2017.pdf.
- Grupi për Studime Juridike dhe Politike, *Sistemi i pensioneve në Kosovë: Shqyrtimi i gjendjes aktuale, sfidat kryesore dhe boshllëqet*, Prishtinë: 2012, marrë nga: <http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy%20Report%2006%202012%20eng.pdf>.
- Rrjeti i Grave të Kosovës, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, Prishtinë: 2014, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20140702111943317.pdf>
- _____, *Me çfarë çmimi? Buxhetimi për zbatimin e kuadrit ligjor kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: RRGK, 2012, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130211130931258.pdf>
- _____, *Mjaft më me arsyetime: Një analizë e qëndrimeve, incidencës, dhe përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë*, Prishtinë, Kosovë, 2015, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20151124105025622.pdf>.
- _____, *Ekonomia e Kujdesit dhe Pjesëmarrja e Grave në Fuqinë e Punës*, Prishtinë: Ardhshme 2016.
- Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, Qarkorja Buxhetore 2015/02 për ministrinë, 2015, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore> <https://kk.rks-gov.net/shterpce/getattachment/688a5d82-37ab-412d-9857-791a1b2909a6/Qarkore-Buxhetore-Komunale-2015-02.aspx>.
- _____, Qarkorja Buxhetore 2015/02 për Komunat, 2015, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore>.
- _____, Projektligji për Buxhetin 2016, 2015, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/en-us/Budget/Budget-of-Republic-of-Kosovo/Central-Budget>.
- MPMS, Udhëzimi Administrativ Nr.05 / 2006 për Themelimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve në Strehim Familjar dhe Birësim, Prishtinë: 2006, marrë nga: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.05-2006%20On%20Establishment%20of%20the%20Panel%20for%20Placing%20Childre.pdf>.
- _____, *Divizioni i Burimeve Njerëzore, Detyrat dhe Përgjegjësitë*, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/en-us/departments/departmentsoffinanceandgeneralservices/humanresourcesdivision.aspx>.
- _____, *Divizioni për Shërbime Sociale, Detyrat dhe Përgjegjësitë*, marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/en-us/departments/departmentsocialpolicyandfamilies/socialservicesdivision.aspx>.
- Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016, 2013, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Declaration_of_Medium-Term_Policy_Priorities.pdf.
- _____, *Plani Kombëtar i Veprimt për Personat me Aftësi të Kufizuara për Republikën e Kosovës*, 2009, marrë nga: http://www.cooperazioneallosviluppo.esteri.it/pdgcs/italiano/iniziativa/pdf/Kosovo_Plan.pdf.
- _____, *Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023*, 2013, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_NACIONALE_PER_TE_DREJTAT_E_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE..._Shq+Ser+Ang.pdf.
- Farsvenden, Ulf Nicole Farnsworth dhe Ariana Qosaj-Mustafa për Orgut, *Profili Gjinnor i Vëndit*, Prishtinë: Sida, 2014, marrë nga: <http://womensnetwork.org/documents/20140513160130237.pdf>.
- Telegrafi, Artikull: "Konfirmohet rritja e të ardhurave të asistencës sociale për 25 për qind", 2015, marrë nga: <http://www.telegrafi.com/lajme/konfirmohet-rritja-e-te-ardhurave-te-asistences-sociale-per-25-per-qind-2-72772.html>, qasur më 16.11.2015
- Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2006, marrë nga: <http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml>.
- _____, *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës*, 1989, marrë nga: <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>.
- UNDP, *Vlera e vërtetë e Asistencës Sociale: Një vlerësim i Asistencës Sociale mbi nivelin e Mjaftueshmërisë*, Prishtinë: UNDP, 2014, marrë nga: <http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Communications/Dokumenti%20The%20Real%20Value%20of%20Social%20Assistance%20ONLINE.pdf>.
- Banka Botërore, *Reforma Pensionale e Kosovës: Arritjet dhe Mësimet*, Prishtinë: 2007, marrë nga: <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf>.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

36.073(496.51)”2016/2018”
336.121(496.51)”2016/2018”

Morina, Donjeta

Buxheti drejt Mirëqenies Sociale : analizë gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë 2016-2018 / Donjeta Morina, Nicole Farnsworth. – Prishtinë : Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2015. - 52 f. ; 21 cm.

Bibliografia : f. 49-51

I.Farnsworth, Nicole

ISBN 978-9951-8852-9-4

ISBN 978-9951-8852-9-4

